

**Bashkimi Evropian**  
**Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve**

**Raporti Përfundimtar**  
**Zgjedhjet Parlamentare në Kosovë**  
**2017**



# ZGJEDHJET PARLAMENTARE NË KOSOVË\*

11 QERSHOR 2017

## RAPORTI PËRFUNDIMTAR

### BASHKIMI EVROPIAN MISIONI PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE

*Misionet e Vëzhgimit të Zgjedhjeve nga Bashkimi Evropian janë të pavarura nga institucionet e Bashkimit Evropian. Informatat dhe pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë të autorit(ëve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian. As institucionet dhe organet e Bashkimit Evropian, as ndonjë person që vepron në emër të tyre, nuk mund të mbahen përgjegjës për përdorimin e mundshëm të informacionit që përmban ky raport. Raporti është në dispozicion në versionet në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe. Vetëm raporti në gjuhën angleze duhet të merret si version zyrtar.*

\*Ky emërtim nuk paragjykon qëndrimin ndaj statusit, dhe është në përputhje me RKSKB 1244/1999 dhe mendimin e GJND-së mbi shpalljen së pavarësisë së Kosovës.

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>I.</b>	<b>PËRMBLEDHJE</b> .....	<b>4</b>
<b>II.</b>	<b>HYRJE</b> .....	<b>7</b>
<b>III.</b>	<b>SFONDI POLITIK</b> .....	<b>8</b>
	A. KONTEKSTI POLITIK.....	8
	B. AKTERËT KRYESORË POLITIKË .....	8
<b>IV.</b>	<b>KORNIZA LIGJORE</b> .....	<b>9</b>
	A. VEÇORITË KRYESORE .....	9
	B. SISTEMI ZGJEDHOR.....	10
	C. TË DREJTAT ZGJEDHORE.....	11
	D. AFATET E SHKURTUARA KOHORE PËR ZGJEDHJET.....	12
<b>V.</b>	<b>ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE</b> .....	<b>12</b>
	A. ORGANET MENAXHUESE TË ZGJEDHJEVE .....	12
	B. REGJISTRIMI I VOTUESVE .....	15
	C. ZGJEDHJET NË KATËR KOMUNAT VERIORE.....	16
	D. VOTIMI JASHTË KOSOVËS .....	16
	E. CERTIFIKIMI I SUBJEKTEVE PËR ZGJEDHJE .....	18
<b>VI.</b>	<b>FUSHATA</b> .....	<b>19</b>
<b>VII.</b>	<b>FINANCIMI I FUSHATËS</b> .....	<b>21</b>
<b>VIII.</b>	<b>MEDIAT</b> .....	<b>22</b>
	A. MJEDISI MEDIAL .....	22
	B. KUADRI LIGJOR PËR MEDIAT .....	22
	C. RREGULLIMI I FUSHATËS MEDIALE.....	23
	D. MONITORIMI I MEDIAVE NGA MVZ I BE-SË .....	24
<b>IX.</b>	<b>DITA E ZGJEDHJEVE</b> .....	<b>26</b>
<b>X.</b>	<b>PROCEDURAT PAS DITËS SË ZGJEDHJEVE</b> .....	<b>27</b>
	A. PUBLIKIMI I TË DHËNAVE TË PARAKOHSHME TË ZGJEDHJEVE (“K-VOTE”).....	27
	B. QENDRA E NUMËRIMIT DHE E REZULTATEVE .....	27
<b>XI.</b>	<b>XI. KONTESTET ZGJEDHORE</b> .....	<b>30</b>
	A. PARASHTRISAT DHE ANKESAT.....	30
	B. MBROJTJA E VOTËS .....	32
<b>XII.</b>	<b>VËZHGESIT E ZGJEDHJEVE</b> .....	<b>34</b>
	<b>REKOMANDIMET</b> .....	<b>35</b>
	<b>SHTOJCA 1: REZULTATET E CERTIFIKUARA TË ZGJEDHJEVE</b> .....	<b>45</b>
	<b>SHTOJCA 2: MONITORIMI I MEDIAVE</b> .....	<b>47</b>

## I. PËRMBLEDHJE

Pas mocionit të mosbesimit të votuar në Kuvendin e Kosovës më 10 maj 2017, Presidenti i Kosovës i shpalli zgjedhjet e parakohshme parlamentare për datën 11 qershor. Votuesit e Kosovës u ftuan që t'i zgjedhin 120 deputetët e Kuvendit përmes një sistemi proporcional të përfaqësimit me votim preferencial, me ulëse të garantuara për komunitetet joshumicë, dhe me një kuotë gjinore prej 30 përqind. Këto ishin zgjedhjet e treta parlamentare që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008.

Zgjedhjet e parakohshme të 11 qershorit 2017 ishin vërtetë konkurruese dhe të qeta në pjesën më të madhe të Kosovës, dhe votuesve përgjithësisht iu ofruan informata pluraliste mbi forcat politike në garë. Megjithatë, procesi i zgjedhjeve u ndikua negativisht nga një sërë mangësi serioze që prej kohësh, të cilat duhet të adresohen nëse Kosova dëshiron që ta demonstrojë përkushtimin e saj ndaj standardeve evropiane, në veçanti: pasaktësia e listave të votuesve që janë të cënueshme nga mashtrimi, korniza paarsyeshëm e shkurtër kohore për zgjedhje të parakohshme, sistemi kryesisht i mangët për votimin jashtë Kosovës, proces jo-mjaftueshëm i saktë dhe transparent në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, dhe përgjigjja e pamjaftueshme ndaj dhunës dhe frikësimeve në viset serbe të Kosovës. Këto çështje do të kërkojnë vullnet të fortë politik dhe angazhim nga ana e udhëheqjes së ardhshme të Kosovës.

Dita e zgjedhjeve megjithatë ishte e qetë dhe nuk u vërejt asnjë incident i madh nga MVZ i BE-së, duke përfshirë edhe veriun e Kosovës. Votimi në përgjithësi u vlerësua pozitivisht; megjithatë, vëzhguesit kanë vënë re një nivel të lartë të votimit familjar, raste të shpërdorimit të votimit me asistencë, dhe prani të tepruar të vëzhguesve nga dy subjekte politike në kundërshtim me ligjin. Procedurat e numërimit të votave nuk u ndoqën gjithmonë, duke nënvizuar nevojën për trajnim më të mirë të stafit të vendvotimit. Prania e madhe e grupit vëzhgues vendas 'Demokracia në Veprim' kontribuoi në transparencën dhe integritetin e zgjedhjeve. Në katër komunat veriore, prania substanciale e komunitetit ndërkombëtar ndihmoi në sigurimin e një procesi të qetë.

Brenda komunitetit serb të Kosovës, mjedisi i fushatës u shëmtua nga një model i thellë frikësimi dhe rastet e dhunës nga brenda komunitetit serb të Kosovës kundër kandidatëve dhe votuesve, si dhe reagimi i pamjaftueshëm nga institucionet për zbatimin e ligjit. Kjo përfshiu ushtrimin e trysnisë mbi kandidatët individualë për t'u tërhequr dhe incidentet e përsëritura të dhunshme në Leposaviq, duke vënë në shënjestër posaçërisht partitë politike dhe kandidatët që sfidonin mbizotërimin e Listës Srpska (Srpska Lista). Gjatë fushatës, pati raste të përsëritura ku zyrtarët e lartë në Beograd nxitën votuesit për ta votuar Listën Srpska. BE-ja dhe anëtarët tjerë të bashkësisë ndërkombëtare dhanë disa deklaratë që bënë thirrje për t'i dhënë fund frikësimit, dhe MVZ nga BE lëshoi një komunikatë për shtyp me të njëjtin qëllim më 5 qershor.

Korniza ligjore siguron një bazë të mjaftueshme për zgjedhje në përputhje me standardet ndërkombëtare, ndaj të cilave Kosova është zotuar në Kushtetutën e saj, por përmban dispozita sfiduese që zgjedhjet e parakohshme legjislativë duhet të mbahen në mes 30 dhe 45 ditësh pas shpërbërjes së Kuvendit, që është një kornizë paarsyeshëm e shkurtër kohore. Në këtë rast, Presidenti u përcaktua për mbajtjen e zgjedhjeve në kornizën më të shkurtër të mundshme kohore, 30 ditë, duke rezultuar në afate shumë sfiduese për përgatitjen e zgjedhjeve. Kjo ka ndikuar negativisht në të gjithë procesin. Disa afate ligjore nuk janë respektuar, siç janë certifikimi i kandidatëve për listat nga komunitetet joshumicë, emërimi i këshillave të vendvotimeve, dhe dërgimi i materialeve zgjedhore te votuesit e regjistruar për votim jashtë Kosovës.

Për shkak të shqetësimit të ndarë nga shumëkush që si pasojë e dy vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nga viti 2014, vetëm subjektit politik që merr më së shumti ulëse mund t'i jepet mundësia për të formuar ekzekutivin e ardhshëm, shumica e partive kryesore politike në anën e shqiptarëve të Kosovës u rigrupuan në koalicione parazgjedhore të momentit të fundit. Sistemi zgjedhor me lista të hapura çoi në rivalitet ndërmjet partive politike brenda këtyre koalicioneve parazgjedhore meqë ato duhej të garonin për vota preferenciale në të njëjtat lista. Kjo gjithashtu e bëri më kompleks vëzhgimin nga përfaqësuesit e garuesve, dhe e shndërroi emërimin e këshillave të vendotimeve në çështje kontestuese.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) formoi një koalicion parazgjedhor me Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Nismën për Kosovën (NISMA) dhe partitë më të vogla. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca Kosova e Re (AKR) formuan një koalicion tjetër. Ndër partitë kryesore shqiptare në Kosovë, vetëm Vetëvendosje garoi e vetme.

Spektri politik i komunitetit serb të Kosovës ishte i fragmentuar, me subjekte politike si Partia e Serbëve të Kosovës (Partija Kosovskih Srba - PKS), Partia e Pavarur Liberale (Samostalna Liberalna Stranka - SLS) dhe Partia Progresive Demokratike (Progresivna Demokratska Stranka - PDS) duke sfiduar mbizotërimin e Listës Srpska. Pati raste të përsëritura ku zyrtarët e lartë serbë nga Serbia nxitën votuesit për ta votuar Listën Srpska.

Me përjashtim të viseve me shumicë serbe, atmosfera e fushatës ishte kryesisht e qetë, duke u mundësuar subjekteve politike që të përcjellin lirshëm mesazhet e tyre për votuesit. Garuesit në përgjithësi u përmbajtën nga gjuha nxitëse. Megjithatë, siç kishte ndodhur edhe në zgjedhjet e mëparshme, subjektet politike filluan aktivitetet e fushatës para fillimit zyrtar të fushatës, dhe vëzhguesit e MVZ nga BE raportuan raste të përdorimit të resurseve publike për qëllime fushate. Gjithashtu, nga disa rajone janë marrë pretendime se ka pasur presion dhe frikësim të votuesve.

Kandidatet femra nuk gëzuan mbështetje të njëjtë për fushatat e tyre nga subjektet e tyre politike. Paratë dhe mbulimi nga mediat ishin me prioritet për kandidatët meshkuj. Gratë rrallë ishin në pozita drejtuese në ekipet e fushatave. Kandidatet femra rrallëherë folën nëpër tubime, dhe pjesëmarrja e grave në jetën publike nuk u diskutua pothuaj asnjëherë.

Përderisa ekziston korniza ligjore për financimin e fushatës zgjedhore, ajo bëhet e paefektshme nga mungesa e monitorimit dhe kontrollit sistematik nga një subjekt i pavarur me mjete dhe procedura efektive.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është politikisht përfshirës, mbledhjet e tij në përgjithësi kanë qenë të hapura dhe ai kryesisht vepron në mënyrë transparente. Është orvatur që vendimet t'i marrë me konsensus, dhe si rregull, bëri përpjekje që ta realizojë një proces transparent dhe të mirëfilltë, nën rrethanat veçanërisht sfiduese të afateve të shkurtuara kohore. Megjithatë, kishte vonesa në informimin e votuesve, dhe në publikimin e vendimeve dhe në përvetësimin e masave parandaluese kundër mashtrimit. Prania e grave në administrimin e zgjedhjeve mbetet tepër e ulët.

Për këto zgjedhje, KQZ-ja regjistroi 1,872,941 votues bazuar në të dhënat e regjistrave civil. Listat e votuesve vazhdojnë të mbesin çështje shqetësuese, veçanërisht prania e emrave të personave të vdekur, fakti se votuesit nuk caktohen në mënyrë konsistente në vendvotimin më të afërt, dhe risku që të dhënat e votuesve që banojnë jashtë vendit në listat e votuesve të komunave të prejardhjes mund të keqpërdoren në ditën e zgjedhjeve. Për këto zgjedhje, votuesit patën mundësi të kufizuara që t'i verifikojnë të dhënat e tyre në listën e votuesve dhe të kërkojnë ndryshime, kryesisht për shkak të afateve të shkurtuara kohore dhe fushatës së kufizuar të informimit.

Certifikimi i kandidatëve ishte kryesisht pa kundërshtime, megjithatë, u zhvillua një kontest i ndërlikuar lidhur me certifikimin e shqiptarëve 'etnik' të deklaruar të Kosovës, të prezantuar si kandidatë në dy lista që garonin për ulëset e garantuara për komunitetet joshumicë. Këto raste ilustronë dobësitë në sistem për përfaqësimin e partive jo-shumicë, veçanërisht mjetet e paqarta ligjore që KQZ-ja i ka në dispozicion për të parandaluar shpërdorimet, dhe mosgarantimi i të drejtës për mjet juridik efektiv kur zgjedhjet mbahen brenda një afati të shkurtuar kohor.

Kishte udhëzime të paqarta se a duhet të pranohen të gjitha llojet e dokumenteve të identifikimit të Serbisë si dokumente të vlefshme identifikimi për votim. Kjo rezultoi në huti në Leposaviq dhe disa vise tjera në ditën e zgjedhjeve.

Në pajtim me marrëveshjen ndërmjet KQZ-së dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe si masë për ndërtimin e besimit, personeli ndërkombëtar i OSBE-së ishte i pranishëm në secilin Këshill të Vendvotimit (KVV) në komunat veriore për të ofruar këshilla dhe ndihmë, dhe me autoritetin për t'i raportuar KQZ-së për shkeljet. Personeli i OSBE-së po ashtu përcolli transportimin e materialeve të ndjeshme nga KQZ-ja.

Kosova ka një mjedis mediatik pluralist dhe një kornizë të shëndoshë ligjore për liri të mediave. Ligji për zgjedhjet kërkon mbulim korrekt dhe të paanshëm nga mediat, lejon reklamimin me pagesë dhe parasheh edhe ca hapësirë transmetuese falas. Dispozitat e paqarta ligjore u kanë mundësuar garuesve të blejnë gjerësisht mbulim të sponsorizuar të ngjarjeve të fushatës, përveç reklamimit të paguar politik të rregulluar në mënyrë të rreptë.

Mediat e mbuluan gjerësisht fushatën zgjedhore, dhe në përgjithësi u ofruan votuesve informata pluraliste për forcat politike që ishin në garë. Mbulimi i lajmeve nga kanalet kryesore televizive në përgjithësi ishte i baraspeshuar dhe i paanshëm, me përjashtim të dukshëm të dy kanaleve televizive lokale private në gjuhën serbe, *TV Most* dhe *TV Puls*, të cilat pothuajse ekskluzivisht mbuluan Listën Srpska. Megjithatë, kanalet kryesore televizive, në përpjekje për të organizuar debate zgjedhore në pajtim me ligjin, përjetuan ndërhyrje pavend nga koalicioni PAN, i cili kërkoi trajtim të favorizuar. Komisioni i Pavarur për Media luajti kryesisht një rol pasiv.

Pas numërimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) filloi që t'i publikojë të dhënat e zgjedhjeve të parakohshme në uebsajtin e tij, të dërguara në mënyrë elektronike nga personeli i KQZ-së i caktuar në të gjitha qendrat e votimit, sistem ky i njohur si K-Vote. Përderisa ky sistem nuk përfshinte votat jashtë Kosovës ose fletëvotimet me kusht, të cilat u numëruan në qendër në ditët në vijim, ai e rriti transparencën e procesit dhe i dha votuesve indikacione të shpejta mbi trendet e rezultateve.

Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) në Prishtinë ofron një nivel shtesë shumë të nevojshëm të shohitjes për rezultatet e zgjedhjeve dhe në të vërtetë për të gjithë procesin. Ndonëse mbetet e domosdoshme për të siguruar njëfarë niveli të kontrollit të të dhënave nga vendvotimet, dhe për të numëruar fletëvotimet nga votimi jashtë Kosovës dhe ato me kusht, procesi në QNR mund të bëhet më efikas, disa nga metodat e tij marrin shumë kohë pa nevojë, dhe ka pjesë të procesit ku mungon transparenca dhe saktësia, në veçanti sa i përket trajtimit të fletëvotimeve me kusht dhe vendimeve për rinumërim.

Nga gjithsej 2,490 kuti votimi nga qendrat e votimit, 189 u dërguan në karantinë pas mbërritjes në QNR për shkak të numrave të gabuar të shiritave mbyllës, ose materialeve jo të plota ose që mungonin. Më 15 qershor, KQZ-ja vendosi që të rinumërojë 30 prej tyre. KQZ-ja gjithashtu urdhëroi rinumërimin e 395 vendvotimeve të tjera, kryesisht për shkak të

mospërputhjeve midis votave për kandidatët dhe për subjektin e tyre politik. Kjo solli numrin e rinumërimit të vendvotimeve në 425 në atë fazë.

Pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve më 29 qershor nga KQZ-ja, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) u paraqitën 66 ankesa, që çuan në rinumërimin e 117 vendvotimeve shtesë. Rinumërimet çuan në ca ndryshime në shpërndarjen e mandateve. Më 4 korrik, ndaj pesë vendimeve të PZAP-it u paraqitën ankesa në Gjykatën Supreme, e cila i refuzoi tri si të pabaza dhe i pranoi dy të tjerat. Një ankesë në Gjykatën Supreme çoi në rinumërimin e 23 vendvotimeve shtesë. Gjithsej, 565 rinumërimet janë urdhëruar pas ditës së zgjedhjeve. Pas përfundimit të procesit të apelimit, KQZ-ja certifikoi rezultatet më 8 korrik, duke hapur rrugën për krijimin e institucioneve të reja.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka vepruar sipas ligjit dhe rregulloreve të veta të brendshme, duke ndjekur procedurat, duke dhënë bazën ligjore dhe arsyetimin për vendimet e tij, duke publikuar vendimet e tij dhe duke respektuar afatet e shkurtëra kohore.

Në kontrast të plotë me veprimin imponues të disa prej prokurorëve të caktuar dhe madje edhe disa gjyqtarëve nga gjykatat themelore në dhe përreth ditës së zgjedhjeve, është dëshmuar se është kryesisht e pamundur që të shqyrtohen më shumë se 600 pretendime për krime zgjedhore, të cilat i janë përcjellë prokurorisë pas zgjedhjeve parlamentare 2014. Për shkak të mungesës së një sistemi të integruar të menaxhimit të lëndëve ndërmjet prokurorisë dhe sistemit gjyqësor të Kosovës, mbledhja e të dhënave për lëndët e ndjekura është e vështirë. Kjo e ulë besimin në ndëshkrimin e vërtetë të të gjitha ose shumicës së krimeve zgjedhore.

KQZ-ja akreditoi gjithsej 29,264 vëzhgues nga partitë politike, koalicionet, organizatat ndërkombëtare, OJQ-të vendase, ambasadat dhe mediat. Nga këto, 8,830 ishin nga OJQ-të lokale dhe 301 nga organizatat ndërkombëtare. 'Demokracia në Veprim', një koalicion i OJQ-ve, ishte grupi kryesor vendas për vëzhgimin e zgjedhjeve. Ai shpërndau në terren mbi 2,500 vëzhgues dhe publikoi disa raporte për fushatën zgjedhore dhe ditën e zgjedhjeve.

## II. HYRJE <sup>1</sup>

Me ftesën e Presidentit të Kosovës të datës 11 maj 2017, BE e dërgoi një Mision Vëzhgues të Zgjedhjeve (MVZ nga BE) më 19 maj për të vëzhguar zgjedhjet e parakohshme parlamentare të datës 11 qershor 2017. MVZ nga BE e drejtoi z. Alojz Peterle, deputet i Parlamentit Evropian (MEP) dhe ish-kryeministër i Republikës së Sllovenisë. Misioni përbëhej nga një ekip kryesor prej tetë analistësh, 16 vëzhgues afatgjatë (LTO) të cilët ishin të pranishëm nga data 25 maj, dhe 32 vëzhgues afatshkurtër (STO) të cilët ishin të pranishëm nga data 6 deri më 14 qershor. Përveç kësaj, Misionit iu bashkuan 40 vëzhgues afatshkurtër të angazhuar në vend (LSTO) dhe një delegacion nga Parlamenti Evropian i kryesuar nga euro-deputeti Igor Šoltes nga Sllovenia.

Në ditën e zgjedhjeve, gjithsej 103 vëzhgues nga 25 Shtete Anëtare të BE-së, Norvegjia dhe Zvicra raportuan nga të gjitha 38 komunat e Kosovës, duke vëzhguar në 403 vendvotime. LTO-të mbetën në terren për të ndjekur procedurat pas ditës së zgjedhjeve dhe për të vëzhguar aktivitetet e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve në Prishtinë. Ekipi kryesor u largua nga Kosova më 2 korrik, përveç analistit ligjor që qëndroi disa ditë më shumë për të ndjekur procedurat e ankesave dhe parashtresave.

<sup>1</sup> Ndërsa ky raport është përkthyer në shqip dhe serbisht, versioni në gjuhën angleze mbetet i vetmi version zyrtar.

MVZ nga BE vlerësoi të gjithë procesin zgjedhor kundrejt standardeve ndërkombëtare dhe evropiane për zgjedhje demokratike, si dhe ndaj ligjeve të Kosovës. MVZ nga BE është i pavarur në gjetjet dhe konkluzionet e tij dhe vepron në pajtim me Deklaratën e Parimeve për vëzhgimin ndërkombëtar të zgjedhjeve.

MVZ nga BE dëshiron të shprehë mirënjohjen e tij për autoritetet e Kosovës, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe institucionet e tjera, policinë, partitë politike, mediat dhe shoqërinë civile për bashkëpunimin dhe ndihmën e tyre gjatë gjithë pranisë së Misionit. MVZ nga BE gjithashtu çmon bashkëpunimin nga Zyra e BE/EUSR, EULEX, KFOR, OSBE dhe përfaqësitë diplomatike të Shteteve Anëtare të BE-së, Norvegjisë dhe Zvicrës.

### III. SFONDI POLITIK

#### A. Konteksti politik

Pas mocionit të mosbesimit të votuar në Kuvend me 10 maj, Presidenti i Kosovës shpalli zgjedhjet e parakohshme parlamentare për datën 11 qershor. Votuesit e Kosovës u ftuan që të zgjedhin 120 deputetët e Kuvendit përmes një sistemi proporcional të përfaqësimit me votim preferencial, me ulëse të garantuara për komunitetet joshumicë, dhe me një kuotë gjinore prej 30 përqind. Këto janë zgjedhjet e treta parlamentare që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008.

Pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2014, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në njërën anë, dhe koalicioni paszgjedhor i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Nismës për Kosovën (NISMA), të mbështetur nga Vetëvendosje në anën tjetër, kërkuan të drejtën për të propozuar Kryetarin e Kuvendit dhe për të formuar ekzekutivin. Kjo çështje u vendos nga Gjykata Kushtetuese. Në aktgjykimin AGJ 671/14 të datës 1 korrik 2014 mbi kompetencat e Presidentit të Kosovës, ku vendosi që partisë ose koalicionit parazgjedhor që ka fituar shumicën e ulëseve duhet t'i jepet mundësia e parë e përcaktuar sipas kushtetutës për të propozuar kandidatin për Kryeministër. Tutje, Gjykata çmoi se nuk duhet përjashtuar që Presidenti i Kosovës gjithashtu mund të vendosë t'ia japë të njëjtës parti ose koalicion mundësinë e dytë dhe të fundit për të propozuar një kandidat tjetër, por konsideroi që Presidenti duhet të vlerësojë se cila parti politike ose koalicion ka gjasat më të mëdha të propozojë një kandidat që do t'i marrë votat e nevojshme në Kuvend për formimin e ekzekutivit të ri.

Shumica e partive kryesore politike në Kosovë duket të kenë ardhur në përfundim nga vendimi AGJ 671/14 dhe nga vendimi vijues AGJ 700/14 se mbase të dy mundësitë e parapara sipas kushtetutës për të propozuar Kryeministrin dhe formuar ekzekutivin do t'i jepen subjektit të njëjtë më të madh politik parazgjedhor. Një pasojë e drejtpërdrejtë nga kjo duket të jetë mënyra në të cilën partitë politike u vunë në lëvizje që të bëjnë koalicione para zgjedhjeve të 11 qershorit përkundër dallimeve rrënjësore mes tyre.

#### B. Akterët kryesorë politikë

Njëzet e gjashtë subjekte politike u certifikuan nga KQZ për të marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare. Mes tyre ishin pesë shqiptare, gjashtë serbe, dy turke, tri boshnjake, tri rome, tri gorane, dy ashkali dhe dy subjekte egjiptiane.

Subjekti më i madh politik shqiptar i Kosovës ishte koalicioni i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Nismës për Kosovën NISMA, shpesh i referuar si koalicioni 'PAN'. Koalicioni u paraqit në KQZ pak para përfundimit të afatit të caktuar për aplikim për certifikim, dhe përfshiu edhe 12 parti të tjera



më të vogla përveç tri partive kryesore. Këto tri parti, të gjitha të udhëhequra nga ish-prijësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, UÇK, caktuan Ramush Haradinajn (AAK) që të jetë kandidati i tyre për postin e kryeministrit, ndërsa Kadri Veseli (PDK) kryesoi listën e kandidatëve. Koalicioni i dytë më i madh, shpesh i referuar si koalicioni 'LAA', ishte i përbërë nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) e Kryeministrit Isa Mustafa, Aleanca Kosova e Re (AKR) e Behgjet Pacollit, dhe një subjekt i ri, Alternativa, i udhëhequr nga Mimoza Kusari-Lila, Kryetare e Komunës së Gjakovës. Kandidati i tyre për kryeministër ishte Avdullah Hoti. Partia opozitare Vetëvendosje, e udhëhequr nga Visar Ymeri, garoi e vetme dhe paraqiti ish-kreun e partisë Albin Kurti si kandidat të vetin për kryeministër. Përzgjedhja e kandidatëve për kryeministër u bazua në popullaritetin e perceptuar të kandidatëve dhe aftësinë e tyre për të mbledhur vota për subjektin përkatës politik.

Spektri politik i komunitetit serb të Kosovës ishte i fragmentuar, me subjekte politike si Partia e Serbëve të Kosovës (Partija Kosovskih Srba - PKS) e udhëhequr nga Alleksandar Jabllanoviq, Partia e Pavarur Liberale (Samostalna Liberalna Stranka - SLS) e udhëhequr nga Slllobodan Petroviciq, dhe Partia Progresive Demokratike (Progresivna Demokratska Stranka - PDS) e udhëhequr nga Nenad Rashiq, duke sfiduar mbizotërimin e Listës Srpska të mbështetur nga Beogradi dhe nën udhëheqjen e Sllavko Simiq.

Për komunitetet e tjera joshumicë, pretenduesit kryesorë ishin VAKAT, një koalicion i katër partive politike boshnjake (Partia Demokratike e Boshnjakëve, Partia Demokratike Vatan, Partia e Bashkuar e Boshnjakëve, Qendra e Unitetit Demokratik Demokratike / Demokratska Stranka Bošnjaka, Demokratska Stranka Vatan, Ujedinjena Stranka Bošnjaka, Centar Demokratske Unije), Partia e Re Demokratike (Nova Demokratska Partija - NDS), Partia Demokratike Turke e Kosovës (Kosova Demokratik Türk Partisi - KDTP), Partia e Re Rome e Kosovës (Kosovaki Nevo Romani Partia - KNRP), Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), Partia Unike Gorane (Jedinstvena Goranska Partija - JGP) dhe Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK).

#### **IV. KORNIZA LIGJORE**

##### **A. Veçoritë kryesore**

Korniza ligjore ofron bazë të mjaftueshme për zgjedhje demokratike në pajtim me standardet ndërkombëtare për të cilat Kosova është zotuar në Kushtetutën e saj, por përmban dispozita sfiduese për zgjedhjet e parakohshme. Nga viti 2011, ka pasur disa përpjekje të pasuksesshme për reformim gjithëpërfshirës të sistemit zgjedhor dhe për të adresuar mangësitë e identifikuar më herët, duke përfshirë mundësinë e shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme brenda një periudhe jashtëzakonisht të shkurtër, dhe si rezultat, afatet e shkurtuara kohore në kalendarin zgjedhor, që cunjojnë disa të drejta zgjedhore.

Prandaj, me fare pak përjashtime (në rregulloret zgjedhore), korniza ligjore që rregulloi zgjedhjet e mëparshme parlamentare dhe lokale mbeti në fuqi për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 2017-ës. Dokumentet kyçe të legjislacionit në Kosovë janë Kushtetuta e Kosovës e vitit 2008 dhe Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) i 5 qershorit 2008, i cili u ndryshua në tetor 2010 për të futur disa ndryshime lidhur me procedurat e ankesave dhe parashtresave, si dhe me sistemin e votimit preferencial. Legjislacioni përkatës sekondar përfshin Rregulloren e Punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të datës 4 shtator 2008; Rregulloren e Punës së Panelit për Ankesa dhe Parashtresa Zgjedhore (PZAP) nga dhjetori 2015, të cilat zgjerojnë ligjin në lidhje me paraqitjen e ankesave dhe parashtresave; dhe 19 rregullat e nxjerra më 2013, 2015 dhe 2016 nga KQZ, të cilat zgjerojnë parimet e përfshira në LZP. Ligje të tjera të rëndësishme që lidhen me procesin zgjedhor janë Kodi

Penal i datës 22 prill 2012, Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe anëtarëve të tyre në Kosovë (LMPDK), i ndryshuar në 2011 dhe 2012, Ligji për përdorimin e gjuhëve i 27 korrikut 2006, dhe Ligji për financimin e partive politike të 16 shtatorit 2010, ndryshuar në vitin 2011 dhe 2013.

Kosova nuk është palë nënshkruese e asnjë instrumenti ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Megjithatë, neni 22 i Kushtetutës përcakton zbatimin e drejtpërdrejtë të një sërë marrëveshjesh dhe instrumentesh relevante për zgjedhjet<sup>2</sup>. Për më tepër, neni 53 i Kushtetutës i detyron autoritetet e Kosovës që të interpretojnë të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me ligj dhe kushtetutë në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Të drejtat e mishëruara në KEDNJ (ECHR) janë drejtpërdrejt të zbatueshme, dhe në rast konflikti kanë epërsi ndaj dispozitave të ligjeve të Kosovës<sup>3</sup>. Përveç kësaj, më 11 qershor 2014, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës miratoi anëtarësimin e Kosovës në Komisionin Evropian për Demokraci përmes Ligjit, i njohur si Komisioni i Venedikut. Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i Komisionit të Venedikut nga tetori 2002 tani ka përforcuar rëndësinë si referencë për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike në Kosovë.

Disa nga mangësitë në ligj të cilat erdhën në shprehje gjatë këtyre zgjedhjeve janë e drejta për të shkurtuar afatet brenda kalendarit zgjedhor për zgjedhje të parakohshme, duke cunguar kështu të drejtat zgjedhore, mungesa e qartësisë rreth asaj se si mund të vlerësohet kualifikimi për të garuar si kandidat për subjektet politike joshumicë; dhe rregulla shumë e përgjithshme për përfaqësimin joshumicë në trupat e menaxhimit të zgjedhjeve.

Boshllëqet e tjera në LZP janë plotësuar me dispozitat në 19 rregullat e KQZ-së dhe në Rregulloren e Punës të PZAP-së, ndonëse ato duhet të rregullohen me ligj, meqë kanë të bëjnë me aspektet vendimtare të procesit zgjedhor. Këto përfshijnë në veçanti procedurat në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), të cilat adresohen vetëm në Rregullën e KQZ-së nr.6 dhe nr.9. Procedura për të vendosur mbi anulimin e rezultateve të zgjedhjeve dhe urdhërimin e rivotimit është e paqartë në LZP, dhe vetëm paksa e rregulluar në Rregullën e KQZ-së nr.9 dhe nr.6. Në fund, LZP në kombinim me Ligjin për ndryshimin e LZP-së shkakton konfuzion gjatë leximit sa i përket afateve përkatëse për parashtrimin e ankesave dhe praktikisht nuk jep udhëzime lidhur me përmbajtjen e nevojshme të ankesave të tilla. Këto rregulla gjenden në Rregulloren e Punës të PZAP-it, të cilat sigurojnë detajet e nevojshme<sup>4</sup>.

## B. Sistemi zgjedhor

Të 120 deputetët e Kuvendit të Kosovës zgjedhen për mandat katërvjeçar, në një zonë të vetme zgjedhore, përmes sistemit proporcional me ulëse të garantuara për komunitetet

<sup>2</sup> Këtu përfshihen Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR/PNDPCP), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (ECHR/KEDNJ) dhe Protokollat e saj, Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, dhe Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW).

<sup>3</sup> Megjithatë, pasi që Kosova nuk është palë e ECHR, banorët e Kosovës nuk kanë mbrojtje juridike në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Interpretimi dhe zbatimi i të drejtave të tyre, pra, mbetet në kuadër të sistemit gjyqësor të Kosovës. Besimi i publikut në sistemin gjyqësor të Kosovës është i ulët, dhe mund të kalojnë disa vite deri në mbajtjen e seancës së parë për lëndët, si civile ashtu edhe penale.

<sup>4</sup> Në të vërtetë, në lidhje me afatin për parashtrimin e ankesave parazgjedhore Rregullorja e Punës ndryshon nga LZP (72 orë, në Rregulloren e Punës 24 orë). PZAP me sa duket nuk i refuzon ankesat parazgjedhore përderisa ato paraqiten brenda 72 orëve nga shkelja e pohuar, dhe praktikisht të gjitha ankesat parashtrihen brenda 24 orëve gjithsesi. Sidoqoftë, do të ishte me rëndësi përhapja më e gjerë e informacionit në lidhje me kërkesën për sigurimin e provave ose dhënien e indikacioneve të provave me ankesën, dhe t'i jepet ankuesve më shumë kohë dhe informata për të përgatitur siç duhet ankesat e tyre.

joshumicë, me votim preferencial për kandidatët dhe me një kuotë gjinore. Njëzet ulëse janë të garantuara për komunitetet joshumicë, përfshirë 10 për komunitetin serb të Kosovës.<sup>5</sup>

Votuesit e shënjojnë zgjedhjen e tyre për subjektin politik, dhe po ashtu mund t'i shënjojnë preferencat për deri në pesë kandidatë nga subjekti i zgjedhur politik. Nëse në fletëvotim janë shënjuar më shumë se pesë kandidatë, preferencat bëhen të pavlefshme dhe numërohet vetëm vota për subjektin politik.

Nga ulëset që i caktohen një subjekti politik, gjinia e cila ka marrë më pak ulëse kërkohet të ketë të paktën 30% të numrit të përgjithshëm të ulëseve të fituara nga subjekti politik. Nëse nuk është kështu, atëherë kandidatët e gjinisë së mbipërfaqësuar me më pak vota zëvendësohen nga kandidati/ja i/e radhës në listë nga gjinia e nënpërfaqësuar. Zëvendësimet vazhdojnë derisa të dy gjinitë të kenë së paku 30% të ulëseve.

### C. Të drejtat zgjedhore

#### E drejta universale e votës

Korniza ligjore jep një përkufizim gjithëpërfshirës të kualifikimit të votuesve. E drejta universale e votës është e garantuar me nenin 45 të Kushtetutës, ku thuhet “çdo shtetas (...) që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.”

Mirëpo, LZP shkon përtej kësaj, madje kur lexohet së bashku me legjislacionin tjetër relevant, siç është Ligji për Regjistrat Civil dhe Ligji për Shtetësinë, paqartësitë mbeten. Qëllimi i përgjithshëm i këtij korpusi ligjor duket se është për ta bërë kualifikimin për të votuar mbi të gjitha gjithëpërfshirës, ashtu që jo vetëm shtetasit, por çdo person nga mosha 18 vjeçare që do të kualifikohej të jetë shtetas i Kosovës, edhe nëse ai/ajo nuk është, i jepet e drejta për të votuar. Kjo vlen për të gjithë ata votues potencial të cilët, për shkak të ngjarjeve historike dhe lëvizjeve të popullsisë në dekadat e fundit, nuk janë qytetarë të Kosovës. Në të vërtetë, sipas nenit 5 të LZP, personi ka të drejtë për të votuar nëse ai/ajo është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil; ose nëse ai/ajo ishte banor në Kosovë më 1 janar 1998; ose nëse ai/ajo ka fituar statusin e refugjatit më ose pas 1 janarit 1995, dhe ka të drejtë për t'u regjistruar në Regjistrin Qendror Civil me vendqëndrim të rregullt në Kosovë.<sup>6</sup>

Kufizimet e të drejtës për të votuar në LZP mbulojnë rastet kur një person është shpallur i paaftë mendërisht me vendim gjyqësor të formës së prerë, është duke vuajtur dënimin e shqiptuar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ), është i akuzuar nga TPNJ dhe ka dështuar t'i bindet urdhrorit për t'u paraqitur para Tribunalit.

#### Përshtatshmëria/Aftësia e kandidatit

Kriteret e përgjithshme për të qenë kandidat për zgjedhje janë të përcaktuara në LZP. Cilido person emri i të cilit paraqitet në Listën e Votuesve është i përshtatshëm për certifikim, por

<sup>5</sup> Dhjetë ulëset e mbetura shpërndahen si vijon: komuniteti rom (1 ulëse), komuniteti ashkali (1 ulëse), komuniteti egjiptian (1 ulëse), komuniteti rom, ashkali ose egjiptian me numrin më të madh të përgjithshëm të votave (1 ulëse), komuniteti boshnjak (3 ulëse), komuniteti turk (2 ulëse) dhe komuniteti goran (1 ulëse).

<sup>6</sup> Neni 5.1 i LZP:

Çdo person ka të drejtë për të votuar në zgjedhje në përputhje me këtë ligj nëse i ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet në ditën kur mbahen zgjedhjet dhe e plotëson njërin prej kriterëve vijuese:

a) është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil;

b) banon jashtë Kosovës ose ka lëshuar Kosovën në apo pas 1 janarit 1998, me kusht që t'i plotësojë kriteret e parapara sipas ligjit në fuqi për të qenë qytetar i Kosovës; apo

c) ka fituar statusin e refugjatit, siç është përkufizuar në Konventën Lidhur me Statusin e Refugjatëve të 28 korrikut 1951 dhe Protokollin e saj të 16 dhjetorit 1966, në apo pas 1 janarit 1995, dhe ka të drejtë për t'u regjistruar në Regjistrin Qendror Civil si banor i Kosovës;

LZP e kufizon këtë të drejtë duke iu referuar një numri mjaft të madh të kategorive të personave që nuk kanë përshtatshmërinë të jenë kandidatë, p.sh. pjesëtarët e ushtrisë, gjyqtarët dhe prokurorët, anëtarët e çfarëdo trupi të menaxhimit të zgjedhjeve, dhe diplomatët.

Për kandidatët e përfshirë aktualisht në procedura penale, ligji respekton prezumimin e pafajësisë derisa personi të shpallet fajtor nga gjykata. Kështu që, një person i shpallur fajtor për vepër penale me një vendim të gjykatës të formës së prerë në tri (3) vitet e fundit; ose që nuk ka paguar gjobën e shqiptuar nga PZAP apo KQZ; ose që ka dështuar t'i përmbahet ndonjë urdhri të PZAP, nuk ka të drejtë të garojë si kandidat.

Asnjë person që tashmë është anëtar i një organi tjetër të zgjedhur legjislativ (siç është kuvendi komunal) nuk mund të marrë ulëse në Kuvendin e Kosovës, përveç nëse ai/ajo heq dorë nga njëri prej mandateve.

### Të drejtat dhe liritë e tjera të rëndësishme për zgjedhjet

Kushtetuta parasheh parimin e barazisë para ligjit për të gjithë individët, dhe respektimin e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. Secili duhet të gëzojë të drejtën për mbrojtje të barabartë ligjore pa diskriminim në asnjë bazë, dhe të drejtat dhe liritë themelore mund të kufizohen vetëm me ligj.

Dispozitat ligjore gjithashtu parashohin të drejtat dhe liritë që janë thelbësore për një mjedis të favorshëm. Kushtetuta përmban garanci për: lirinë e shprehjes, duke përfshirë të drejtën për të shprehur dhe për të marrë informacione dhe mendime pa u penguar nga askush; lirinë e tubimit paqësor, lirinë e asociimit - që ngërthen në të drejtën për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë për leje, dhe për të themeluar sindikata; lirinë e lëvizjes - të gjithë qytetarët kanë të drejtë të lëvizin lirshëm nëpër tërë territorin dhe të zgjedhin vendbanimin; dhe lirinë dhe pluralizmin e mediave dhe ndalimin e censurës.

### **D. Afatet e shkurtuara kohore për zgjedhjet**

Sipas legjislacionit aktual, zgjedhjet e parakohshme duhet të mbahen ndërmjet 30 dhe 45 ditësh pas shpërbërjes së Kuvendit, një kornizë jashtëzakonisht e shkurtër kohore. Presidenti i Kosovës u përcaktua që të shpallë zgjedhjet në datën më të hershme të mundshme, duke krijuar domosdonë për shkurtim radikal të afateve në kalendarin e zgjedhjeve. Kjo ka ndikuar negativisht në të gjithë procesin, duke përfshirë trajtimin e ankesave dhe parashtrësive parazgjedhore. Disa afate ligjore nuk janë respektuar, siç janë certifikimi i kandidatëve për listat nga komunitetet joshumicë, emërimi i këshillave të vendotimeve, dhe dërgimi i materialeve zgjedhore te votuesit e regjistruar për votim jashtë Kosovës. Kombinimi i afateve të shkurtuara për administrim të zgjedhjeve me afatet për parashtrësia dhe ankesa pati ndikim në të drejtën për mjet juridik efektiv, p.sh. për ndryshime në Listën e Votuesve, për votimin jashtë Kosovës dhe për përfaqësimin e pakicave. Fushata zyrtare po ashtu u reduktua në dhjetë ditë.

## **V. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE**

### **A. Organet Menaxhuese të Zgjedhjeve**

Zgjedhjet e parakohshme legislative janë administruar nga një organ me tri nivele të menaxhimit të zgjedhjeve, që përbëhen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, 38 Komisione Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) dhe 2,490 Këshilla të Vendotimeve (KVV).

KQZ-ja është organ i përhershëm e i pavarur, i përbërë nga njëmbëdhjetë anëtarë. Kryesuesi i saj emërohet nga Presidenti i Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme. Mandati i Kryesuesit të KQZ-së është shtatë vite, i cili fillon nga data e shpalljes së emërimit nga Presidenti<sup>7</sup>. Dhjetë anëtarët tjerë të KQZ-së emërohen si rezultat i nominimit nga grupet parlamentare të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, përfshirë ata që mbajnë vende të garantuara për komunitetin serb të Kosovës dhe komunitetet tjera jo-shumicë.

KQZ-ja mbështetet nga Sekretariati (SKQZ-ja), i cili i zbaton vendimet e KQZ-së, përgatit raporte dhe rekomandime për vendime të KQZ-së dhe kryen detyra administrative, operacionale dhe të tjera sipas udhëzimeve të KQZ-së. Aktivitetet kryesore të SKQZ-së përfshijnë regjistrimin dhe certifikimin e partive politike, informimin e votuesve, shërbimin e votuesve, si dhe të gjithë punën operacionale që ka të bëjë me procesin e zgjedhjeve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Sekretariati i tij ka vepruar në kushte sfiduese për përgatitjen dhe administrimin e zgjedhjeve të vitit 2017 për shkak të periudhës 30 ditore mes shpalljes së zgjedhjeve dhe ditës së zgjedhjeve, që është afati më i shkurtë i mundshëm në rastet e zgjedhjeve të parakohshme. KQZ-ja e ka miratuar planin e saj operacionale me afate shumë të ngushta. Ky afat i shkurtuar më së shumti ka pasur ndikim në çështjet e prokurimit, përgatitjen e listës së votuesve, votimin jashtë Kosovës dhe informimin e votuesve.

Takimet e KQZ-së janë të hapura për vëzhguesit, publikun dhe mediat. Për shumicën e çështjeve, një shumicë e thjeshtë e votave është e mjaftueshme për miratimin e vendimeve me një kuorum prej së paku shtatë anëtarësh të pranishëm. Për çështje të rëndësishme siç është miratimi i rregulloreve të KQZ-së, regjistrimi dhe certifikimi i partive politike dhe shpallja e rezultatit të zgjedhjeve, KQZ-ja përpiqet që të vendosë me konsensus. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë nevojitet një shumicë prej dy-të-tretave. Në praktikë, KQZ-ja i ka miratuar shumicën e vendimeve të saj si organ kolegjal; megjithatë, janë një numër i vogël i çështjeve kontestuese dhe debateve në të cilat anëtarët e KQZ-së kanë akuzuar kolegët e tyre për anshmëri.

Komisionet Komunale të Zgjedhjeve janë emëruar nga KQZ-ja më 17 maj 2017. KKZ-të janë përbërë nga gjashtë deri në njëmbëdhjetë anëtarë të cilët janë nominuar nga partitë politike të cilat e kanë kaluar pragun zgjedhor dhe nga partitë e komuniteteve jo-shumicë të cilat kanë një numër më të dallueshëm të popullatës brenda komunës. KQZ-ja po ashtu ka marrë parasysh edhe rezultatet e zgjedhjeve të fundit komunale.<sup>8</sup> KKZ-të kryesohen nga Zyrtarët Ekzekutivë të cilët punësohen nga KQZ-ja.

Emërimi i anëtarëve të 2,490 Këshillave të Vendvotimeve (KVV-ve) dhe i kryesuesve të tyre ka qenë kompleks. KVV-të kanë së paku pesë anëtarë. Mekanizmi i ngritjes së KVV-ve përcaktohet në nenet 75 deri në 77 të LQP-së. Aty u jepet të drejtë për nominime subjekteve politike të cilat përfaqësohen në Kuvendin e Kosovës si dhe subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendet Komunale gjegjëse të cilat garojnë për zgjedhjet aktuale. KQZ-ja po ashtu i fton subjektet e reja politike të cilat certifikohen për zgjedhjet aktuale, OJQ-të dhe organizatat e tjera civile për t'i dorëzuar nominimet e tyre për KVV-të. Sipas nenit 77.1, një subjekti politik i lejohet që të ketë vetëm një komisioner zgjedhor në një vendvotim të caktuar. Sipas nenit 77.3, emërimi i Kryesuesve të KVV-ve duhet të ndahet në mënyrë të

<sup>7</sup> Mandati shtatëvjeçar i Kryesueses aktuale të KQZ-së Valdete Daka i cili ka filluar më 16 qershor 2010, është vazhduar në mënyrë automatike deri në 90 ditë pas certifikimit të zgjedhjeve për legjislativin të vitit 2017. (LQP, neni.61.3e).

<sup>8</sup> AKR-ja e cila nuk e kishte kaluar pragun në zgjedhjet për legjislativin të vitit 2014, e ka pasur nga një anëtar në dy KKZ, atë të Gjakovës dhe të Mitrovicës së Jugut në bazë të rezultateve të arritura të zgjedhjeve që AKR-ja i ka pasur në këto dy komuna në zgjedhjet e mëparshme.

barabartë mes katër partive politike të cilat kanë fituar shumicën e votave në zgjedhjet e mëhershme për legjislativin në komunën përkatëse.

Zbatimi i këtyre dispozitave është dëshmuar të jetë jopraktik dhe i kontestueshëm. Në të vërtetë, për shkak të faktit se shumë nga partitë politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës dhe në kuvendet komunale në këto zgjedhje kanë garuar punuar së bashku në koalicione parazgjedhore (gjegjësisht si një ‘subjekt politik’), procedura e zakonshme e nominimit u bë jopraktike, pasi që ‘subjektet politike’ të regjistruara për këto zgjedhje dhe ‘subjektet politike’ të përfaqësuara në kuvendin qendror dhe kuvendet komunale nuk përputheshin domosdoshmërisht. Rrjedhimisht, KQZ-ja brenda saj krijoi një formulë të posaçme që u përpoq të siguronte përfaqësim adekuat politik në KVV. Formula i ka caktuar anëtarët dhe kryesuesit e KVV-ve nga mesi i tri subjekteve politike kryesore të shqiptarëve të Kosovës dhe komuniteteve të pranishme në atë komunë ose zonë të caktuar. Formula e përgjithshme ka përcaktuar shtatë poste në KVV për tri subjektet politike kryesore shqiptare në proporcionin 3/2/2 (tre komisionerë për koalicionin PAN / dy për Vetëvendosje / dy për koalicionin LAA), megjithatë, janë miratuar kombinime të ndryshme për të pasqyruar praninë e komuniteteve jo-shumicë dhe rezultatet e tyre zgjedhore në zgjedhjet e mëparshme legjislative në një komunë të caktuar<sup>9</sup>. Ky fleksibilitet lejohet nga ligji, nëse këtë e kërkon nevoja.<sup>10</sup>

KQZ-ja ka pasur diskutime të nxehta në lidhje me nominimet fillestare të anëtarëve të KVV-ve në komunat veriore meqë përbërjet që ishin propozuar fillimisht nga KKZ-të nuk kishin përfaqësim gjithëpërfshirës dhe të balancuar në mesin e subjekteve politike garuese të serbëve të Kosovës.<sup>11</sup> Këto konteste lidhur me nominimet e KVV-ve e kanë vonuar emërimin e tyre nga KQZ-ja deri më 1 qershor 2017, dhe kanë ndikuar në afatin kohor që veçse ishte i ngushtë për trajnimin e anëtarëve të KVV-ve.

Prania e grave brenda administratës së zgjedhjeve ka mbetur shumë e ulët. Ndër 11 anëtarët e KQZ-së, vetëm kryesuesja është grua dhe gratë kanë përfaqësuar vetëm 10.5% të anëtarëve dhe kryesuesve të KKZ-ve. Në vitin 2015, të shtatëmbëdhjetë subjektet kryesore politike në Kosovë e kanë nënshkruar një deklaratë për rritjen e përfaqësimit të grave në proceset zgjedhore për të siguruar përfaqësimin e balancuar të të dy gjinive në minimumin prej 40%. Koordinator i KQZ-së, më 22 maj 2017, ua ka dërguar një e-mail të gjithë anëtarëve të KKZ-ve duke ua rikujtuar atyre këtë deklaratë dhe duke i inkurajuar të gjitha subjektet e certifikuar politike që të emërojnë më shumë gra në KVV. Megjithatë, partitë politike nuk arritën t’i përmbahen zotimit të tyre dhe në vendvotimet e vizituara nga vëzhguesit e MVZ të BE-së në ditën e zgjedhjeve, gratë përfaqësonin vetëm 24% të anëtarëve dhe 18% të kryesuesve. Ana tjetër pozitive e kësaj është se KQZ-ja e ka siguruar balancin gjinor në mesin e trajnerëve, ku gati gjysma e tyre ishin femra.

<sup>9</sup> P.sh. në Mamushë formula i ka ndarë gjashtë poste të KVV-ve në mesin e tri subjekteve politike shqiptare (3x1), partisë turke KDTP (1), partisë rome KNRP (1) dhe partisë turke KTAP (1).

<sup>10</sup> Shih nenin 77.4 të LZZP-së

<sup>11</sup> Sipas përbërjes përfundimtare të miratuar, struktura e KVV-ve në komunën e Leposaviqit i ka dhënë nga një anëtar për secilën nga subjektet politike serbe, një për partinë boshnjake NDS, një për të nominuarin e KKZ-së dhe një për t’u ndarë nga dy koalicionet shqiptare (PAN, LAA). Srpska Lista (GISL) i ka mbajtur shumicën e posteve të kryesuesve në KVV-të veriore (22 nga 31 në komunën e Leposaviqit, 6 nga 13 kryesues të KVV-ve në Zveçan, 17 nga 28 në Mitrovicën Veriore dhe 7 nga 15 KVV në Zubin Potok.

## B. Regjistrimi i votuesve

Kosova ka një sistem pasiv të regjistrimit të votuesve. Sipas nenit 5 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), një person ka të drejtë vote nëse ai/ajo është 18 vjeç apo më i vjetër në ditën e zgjedhjeve dhe i plotëson së paku një nga kushtet e mëposhtme:

- Është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil.
- Banor jashtë Kosovës ose ka lëshuar Kosovën në apo pas 1 janarit 1998, me kusht që t'i plotësojë kriteret e parapara sipas ligjit në fuqi për të qenë qytetar i Kosovës.
- Ka fituar statusin e refugjatit, siç është përkufizuar në Konventën Lidhur me Statusin e Refugjatëve të 28 korrikut 1951 dhe Protokollin e saj të 16 dhjetorit 1966, në apo pas 1 janarit 1995, dhe ka të drejtë për t'u regjistruar në Regjistrin Qendror Civil si banor i Kosovës.

Listat paraprake dhe përfundimtare të votuesve përpilohen nga KQZ-ja duke u bazuar në të dhënat e nxjerra nga Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC) e Ministrisë së Punëve të Brendshme.<sup>12</sup> Lista përfundimtare e votuesve është certifikuar nga KQZ-ja më 31 maj dhe ka përfshirë gjithsej 1,872,941 votues. KQZ-ja ka raportuar se ndryshimet që nga zgjedhjet legjislative të vitit 2014 përfshinin 118,448 votues të rinj të cilët kanë arritur moshën 18 vjeçare që nga zgjedhjet e fundit dhe 36,754 votues të cilët kanë marrë për herë të parë letërnjoftimin e Kosovës. Gjithashtu ja njoftuar se 33,542 votues të vdekur dhe 19,796 persona që kanë hequr dorë nga regjistrimi i Kosovës janë larguar.

Votuesit kanë pasur mundësi të kufizuara për t'i kontrolluar listat e votuesve dhe për të kërkuar ndryshime, kryesisht për shkak të afateve të shkurtuara dhe një fushate të kufizuar të informimit. Listat paraprake të votuesve kanë qenë në dispozicion të publikut në KKZ nga 20 deri më 28 maj, si dhe në faqen e internetit të KQZ-së. Nëse kërkesat për ndryshime janë mohuar, votuesit kanë pasur mundësinë për t'i kundërshtuar vendimet e administratës zgjedhore nga 25 deri më 28 maj, gjatë orarit të punës<sup>13</sup>. Ligji parashikon që konkuresit në zgjedhje dhe organizatat e akredituara të vëzhgimit mund të marrin një kopje të listës së votuesve për të kontrolluar saktësinë e tyre.

Lista e votuesve mund të kundërshtohet në gjykatat e shkallës së parë. Sipas LZP-së, kërkesat e pa arsyeshme për largim ose përfshirje në listën e votuesve, të rregullt ose asaj me postë, duhet të pranohen nga gjykata më së voni deri në 40 ditë para ditës së zgjedhjeve. Gjatë këtyre zgjedhjeve, afatet e shkurtra të lejuara për procesin e publikimit, shqyrtimit, kundërshtimit, konfirmimit dhe proceseve gjyqësore lidhur me listën e votuesve, nënkuptonte se e drejta për një mjet juridik efektiv nuk do të ishte respektuar<sup>14</sup>.

<sup>12</sup> Nëpër komuna, Zyrat Komunale të Gjendjes Civile dhe Zyrat Komunale të Regjistrimit Civil janë 'zyrat e para' të shërbimit të gjendjes civile ku ndodh kontakti me qytetarët dhe ku grumbullohen, regjistrohen dhe mirëmbahen të dhënat e gjendjes civile, dhe ku lëshohen letërnjoftimet.

<sup>13</sup> Kjo periudhë ka përfshirë një vikend, duke zvogëluar edhe më tej mundësinë për kundërshtimin e vendimeve të KKZ-ve dhe të KQZ-së. Në fund, asnjë vendim i administratës së zgjedhjeve nuk është kundërshtuar në gjykatë lidhur me këtë çështje.

<sup>14</sup> Në të vërtetë, autoritetet kanë raportuar se asnjë ankesë e vetme nuk ishte parashtruar në gjykata kundër vendimeve lidhur me listën e votuesve. Por, votuesit kanë pasur mundësi shumë të kufizuara për të kontrolluar listën e votuesve dhe për të kërkuar ndryshime. Listat paraprake të votuesve kanë qenë në dispozicion nëpër KKZ nga data 20 deri më 28 maj, si dhe në faqen e internetit të KQZ-së. Në rast të refuzimit të kërkesës të votuesve për ndryshim, ata kanë pasur mundësinë për t'i kundërshtuar këto vendime në gjykata komunale nga data 25 deri më 28 maj, gjatë orarit të punës. Kjo periudhë e ankesave jo vetëm që është bashkëzuar me vetë periudhën e publikimit të listës së votuesve, por ajo gjithashtu e ka përfshirë një vikend, duke e zvogëluar më tej vetë kohën në dispozicion për parashtrimin e ankesës. Gjithashtu, është mëse e dyshimtë nëse një gjykatë do të nxirrte një vendim mjaft shpejtë për ta përfshirë votuesin në listën e votuesve për këto zgjedhje.

Shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-së së BE-së në mbarë Kosovën, duke përfshirë edhe disa anëtarë të KKZ-ve, besojnë se listat e votuesve nuk janë të sakta, kryesisht për shkak të mos-largimit të regjistrave të disa personave të vdekur. Megjithatë, ARC-ja ka raportuar se ka përmirësim të dukshëm që nga zgjedhjet e vitit 2014, falë një marrëveshjeje të arritur në vitin 2016 me Bashkësinë Islame të Kosovës, e cila mban të dhëna për vdekjet që jo gjithmonë raportohen nga familjet tek autoritetet civile të Kosovës. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së BE-së kanë shprehur gjithashtu shqetësimin se përfshirja e votuesve që banojnë jashtë vendit në listat e votuesve të komunës së tyre të origjinës mund të keqpërdoren në ditën e zgjedhjeve, veçanërisht në zonat rurale. Regjistrimi i vitit 2011 ka përcaktuar se 562,951 njerëz nga Kosova banojnë jashtë vendit. Ata janë të përfshirë në regjistrin e votuesve në mënyrë të ligjshme.

Disa bashkëbisedues të MVZ-së së BE-së, duke i përfshirë autoritetet, kanë thënë se votuesit nuk janë gjithmonë të caktuar në qendrat e votimit më të afërt me vendbanimin e tyre. Kjo thuhet për shkak të mangësive në sistemin e adresave të Kosovës,<sup>15</sup> dhe mënyrës se si KQZ-ja përdor të dhënat e ofruara nga ARC-ja. Veçanërisht, ARC-ja ia ka shpjeguar MVZ-së së BE-së se KQZ-ja e përdor vendbanimin e votuesve ashtu siç janë regjistruar në kohën e lëshimit të dokumenteve të identifikimit, ndërkohë që ata mund të kenë ndryshuar vendbanimin e tyre që atëherë. Megjithëse kjo mund të çojë në çorientimin e disa votuesve në ditën e zgjedhjeve, problemi zbutet nga fakti që qendrat e votimit kanë lista të plota të votuesve në nivel komunal për t'i riorientuar votuesit.

### C. Zgjedhjet në katër komunat veriore

Në përputhje me një marrëveshje ndërmjet KQZ-së dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe si masë për ndërtimin e besimit, personeli ndërkombëtar i OSBE-së ishte i pranishëm në secilin KVV në komunat veriore për të këshilluar dhe ndihmuar dhe me autorizim për t'i raportuar shkeljet në KQZ. Personeli i OSBE-së gjithashtu e ka shoqëruar transportimin e materialeve të ndjeshme nga ana e zyrtarëve të zgjedhjeve.

Numri i përgjithshëm i votuesve ka qenë më i ulët në katër komunat veriore në krahasim me zgjedhjet legjislativ të vitit 2014, nga 62,797 në 58,064. Ky ndryshim është pjesërisht për shkak të mungesës së integritetit të të dhënave nga regjistri civil serb në listat e votuesve, siç ishte bërë për zgjedhjet e vitit 2014 si rezultat i dialogut të Brukselit.

Ka pasur udhëzime të paqarta nga KQZ-ja nëse të gjitha llojet e dokumenteve të identifikimit të Serbisë duhet të pranohen si dokumente identifikimi të vlefshme për votim në katër komunat veriore. Kjo ka rezultuar me konfuzion në ditën e zgjedhjeve në Leposaviq dhe në zona të tjera.

Në ditën e zgjedhjeve, rreth 30 autobusë që vinin nga Serbia i kanë sjellë votuesit në disa nga komunat me shumicë serbe. Është raportuar se kjo është bërë pa probleme.

### D. Votimi jashtë Kosovës

Sipas nenit 6 të LZP-së për të pasur të drejtë për të votuar jashtë Kosovës, votuesi duhet:

a) jetë i regjistruar në Regjistrin Civil të Kosovës dhe të ketë një dokument të identifikimit të Kosovës ose të UNMIK-ut, ose

---

Definitivisht, një ushtrim i tillë do të duhet të bëhet rregullisht gjatë kohës ndërmjet zgjedhjeve dhe kur ka më shumë kohë në dispozicion.

<sup>15</sup> Për shembull, është raportuar se në Vushtrri rreth 7,000 votues janë në listën e votuesve pa adresë të saktë.



b) të jetë në gjendje për të provuar se ka të drejtë për t'u regjistruar në Regjistrin Civil.<sup>16</sup>

#### Aplikimi për votim jashtë Kosovës

Votuesve të kualifikuar për votim jashtë Kosovës (VjK) u është kërkuar që të aplikojnë në KQZ nga data 15 maj deri më 22 maj 2017. KQZ-ja ua ka ofruar votuesve tri opsione për aplikim: përmes postës elektronike, postës ose faksit.<sup>17</sup> Sipas KQZ-së, problemet teknike në lidhje me sistemin e emailit të KQZ-së kanë rezultuar në aplikime të shumëfishta të shumta të cilat e kanë stërngarkuar Divizionin e Shërbimit të Votuesve (VSD) të KQZ-së, pasi është raportuar se votuesit e mundshëm janë përpjekur të dërgojnë disa herë aplikacionet e tyre. Lista përfundimtare e votuesve të regjistruar për VjK-në ka përmbytur disa të dhëna të shumëfishta. Anëtarët e KQZ-së nga Vetëvendosja dhe Lista Srpska i kanë sugjeruar KQZ-së që të zgjasë afatin jashtëzakonisht të shkurtër përtej 22 majit për aplikimet për regjistrimin jashtë Kosovës, por shumica e anëtarëve të KQZ-së nuk i kanë mbështetur këto propozime.

KQZ-ja ka marrë 20,354 aplikacione për votimin jashtë Kosovës. Prej tyre, 15,118 janë regjistruar me sukses dhe 5,236 janë refuzuar, kryesisht për shkak të mungesës së të provuarit të së drejtës për të votuar. Numri më i madh i aplikacioneve për VjK ka ardhur nga Zvicra (5,432), Gjermania (4,340) dhe Serbia (4,395). Numri më i madh i aplikacioneve të refuzuara ishte nga Serbia (2,476), siç raportohet për shkak të një numri të madh të aplikantëve që nuk kanë ofruar dokumente të mjaftueshme për të provuar të drejtën e tyre për të votuar.

MVZ e BE-së ka marrë raporte për disa raste të votuesve nga Novobërda që nuk i kanë gjetur emrat e tyre në listën përfundimtare të votuesve, por i kanë gjetur ata në listën e votuesve të jashtë Kosovës pa aplikuar për këtë. Udhëheqësi i Divizionit të Shërbimit të Votuesve të KQZ-së ka raportuar për gjashtë raste të tilla, ku një person i dëmtuar ka shkuar në zyrën e tij dhe pesë të tjerë i janë raportuar atij nga anëtari i KQZ-së nga komuniteti serb i Kosovës. Nënshkrimet në aplikimin për regjistrimin e votuesit për VjK kanë dalluar nga ato në dokumentin e identifikimit të votuesit. Udhëheqësi i DSHV-së e ka pranuar se në sistemin e tanishëm të aplikimit për VjK me email dhe duke marrë parasysh afatin e shkurtër, nuk ka pasur asnjë masë mbrojtje kundër paraqitjes së rreme si person tjetër dhe nuk ka pasur mjete juridike në rast të refuzimit të mundësisë për të votuar. Pasi që asnjë ankesë nuk ishte dorëzuar në PZAP, i gjithë dokumentacioni i është dërguar Kryeshefit Ekzekutiv dhe Kryesueses së KQZ-së.

#### Fletëvotimet e VjK-së

Me qëllim të adresimit të çështjeve të ngritura nga periudha jashtëzakonisht e shkurtër për informim dhe dërgimin e fletëvotimeve me postë (1 qershor - 9 qershor), DSHV-ja u ka dërguar emaile atyre votuesve të cilët ishin regjistruar për të votuar jashtë Kosovës në zgjedhjet e mëparshme, me udhëzime se si të votojnë nga jashtë vendit.<sup>18</sup> KQZ-ja e ka zgjatur afatin për pranimin e fletëvotimeve me postë për VjK-në për një ditë, deri më 10 qershor 2017 në mesnatë. Deri në atë kohë, ajo kishte marrë 4.574 zarfe për VjK me 5.949 zarfe të

<sup>16</sup> P.sh. votuesit me të drejtë vote të cilët përkohësisht banojnë jashtë Kosovës ose janë zhvendosur nga Kosova (p.sh. banori i Kosovës më 1 janar 1998 i cili është lindur në Kosovë ose njëri nga prindërit e tij/saj është lindur në Kosovë apo ka jetuar në Kosovë për së paku pesë vite të njëpasnjëshme ose i cili është deportuar nga Kosova dhe rrjedhimisht nuk e ka pasur mundësinë për të jetuar në Kosovë për pesë vite të njëpasnjëshme).

<sup>17</sup> Votuesit të cilët janë regjistruar me sukses për votimin jashtë Kosovës përmes postës në zgjedhjet për legjislativin të vitit 2014 nuk ka pasur nevojë që të provojnë prapë të drejtën e tyre për të votuar, ata është dashur që vetëm të provojnë identitetin e tyre në aplikacionet e tyre.

<sup>18</sup> Emailt e kanë përmbytur një vegëz që ka ofruar qasje në fletëvotim i cili duhej të shtypej, broshurën që ka përmbytur listën e të gjithë kandidatëve, udhëzimet se si të futet fletëvotimi në zarfin e fshehtësisë dhe një fotokopje të një dokumenti të identifikimit në zarfin e jashtëm, si dhe adresën postare se ku duhet dërguar më pastaj fletëvotimi me postë.

fshehtësisë brenda tyre. DSHV-ja e ka njoftuar MVZ-në e BE-së se rreth 3,700 zarfe postare për VjK kanë arritur pas afatit, ndërmjet 12 qershorit dhe 21 qershorit. Ato nuk janë pranuar.

Në ditën e zgjedhjeve, DSHV-ja ka filluar verifikimin e të drejtës për të votuar të votuesve jashtë Kosovës dhe vlefshmërinë e zarfeve të VjK-së. Pas një shqyrtimi tre-ditor, ai ka refuzuar 703 prej tyre, kryesisht të dërguara nga persona që nuk ishin regjistruar për votimin jashtë Kosovës. Votat me postë të VjK-së janë renditur sipas komunave dhe janë dorëzuar në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) më 14 qershor ku votat e VjK-së janë numëruar më 23-24 qershor 2017 (shih më poshtë).

Derisa pjesëtarët e diasporës kosovare kanë të drejtë të votojnë, si metoda e votimit jashtë Kosovës ashtu edhe zbatimi i saj kanë dështuar të ofrojnë një sistem funksional, gjithëpërfshirës dhe të sigurt nga mashtrimet, për ushtrimin e të drejtës së tyre për të votuar.

### **E. Certifikimi i subjekteve për zgjedhje**

Për të kandiduar për zgjedhje, garuesit e mundshëm duhet të certifikohen si 'subjekt politik' nga KQZ-ja. Një 'subjekt politik' mund të jetë një parti politike, një koalicion i partive politike, një iniciativë qytetare ose një kandidat i pavarur. Partitë politike të regjistruara certifikohen automatikisht.

Të 26 subjektet politike që kanë aplikuar për të garuar në zgjedhje janë certifikuar nga KQZ-ja më 23 maj. Gjithsej pesë koalicione, 19 parti politike dhe dy iniciativa qytetare kanë marrë pjesë. Njëzetënjë subjekte politike kanë konkurruar për 20 vendet e garantuara për komunitetet jo-shumicë, ndërsa pesë subjekte politike të shumicës shqiptare të Kosovës kanë konkurruar për 100 vendet e tjera.

Gjithsej, janë certifikuar 971 kandidatë: 487 kandidatë kanë konkurruar në pesë listat që garonin për 100 vende, ndërsa 484 kandidatë kanë konkurruar në 21 lista për 20 vendet e garantuara.

Certifikimi i kandidatëve është dëmtuar nga një mosmarrëveshje rreth certifikimit të shqiptarëve etnikë të deklaruar si kandidatë në dy lista që konkurrojnë për vende të garantuara për komunitetet jo-shumicë. Të dy listave - koalicionit boshnjak SDA-BSDAK dhe partisë turke KTAP - më pas iu është kërkuar nga KQZ-ja t'i heqin këta kandidatë, përndryshe partitë nuk do të certifikohen. KTAP-ja e ka pranuar këtë kërkesë, kandidatët e kontestuar të SDA-BSDAK janë larguar nga lista nga ana e KQZ-së dhe subjektet politike janë certifikuar. Të dy garuesit megjithatë janë ankuar ndaj vendimit për certifikim. Në rastin e KTAP-së, ankesa ishte refuzuar me arsyetimin se KQZ-ja kishte certifikuar listën e kandidatëve ashtu siç është ndryshuar nga partia. Çështja e SDA-BSDAK-së i është kthyer KQZ-së në baza procedurale, por vendimi lëndor për largimin e kandidatëve në fund është miratuar nga PZAP-i dhe Gjykata Supreme me arsyetimin se Kushtetuta parasheh përfaqësimin e grupeve jo-shumicë. Si KTAP-ja ashtu edhe SDA-BSDAK-ja kanë pohuar se disa nga listat e konkurrentëve të tyre janë certifikuar përkundër përfshirjes së kandidatëve që nuk i përkasin grupit jo-shumicë të cilin ata kanë zgjedhur për ta përfaqësuar.

Këto raste ilustrojnë vështirësitë në zbatimin e sistemit për përfaqësimin e partive jo-shumicë, veçanërisht: mjetet e paqarta ligjore për KQZ-në për të parandaluar abuzimet; mungesa e aplikimit të barabartë të procesit të verifikimit të kandidatëve; dhe afatet e shkurtuara që janë zbatuar, jo gjithmonë duke garantuar të drejtën për mjete juridike efektive në procesin zgjedhor.

Ka pasur kritika publike ndaj subjekteve politike për mungesën e transparencës në formimin e listave të tyre të kandidatëve, si dhe praninë e mundshme të kandidatëve me dosje penale.

Shoqëria civile ka ngritur shqetësime në lidhje me cilësinë e listave të kandidatëve dhe, si pjesë e një fushate të edukimit të votuesve, u ka kërkuar votuesve që të mos votojnë për kandidatët e korruptuar. Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) e ka informuar MVZ-në e BE-së se presioni nga shoqëria civile ka rezultuar që PDK-ja, për shembull, i ka larguar disa kandidatë të perceptuar si të korruptuar nga listat e saj.

## VI. FUSHATA

Fushata zyrtare filloi më 31 maj dhe përfundoi më 10 qershor, 24 orë para fillimit të procesit të votimit. Siç ishte rasti në zgjedhjet e mëparshme, subjektet politike filluan aktivitetet e fushatës para fillimit zyrtar të fushatës, veçanërisht nëpër media. Në mungesë të rregulloreve të para-fushatës, të gjitha 20 ankesat e parashtruara për këtë periudhë u refuzuan nga PZAP-i.

Atmosfera e fushatës ishte kryesisht e qetë në zonat me shumicë shqiptare të Kosovës, duke u intensifikuar kah fundi, me tubime më të mëdha që mbaheshin nga koalicionet e mëdha dhe nga Vetëvendosja. Garuesit bënë fushatë të lirë në shumicën e rajoneve dhe përgjithësisht u përmbajtën nga gjuha provokuese.

Partitë politike bënë fushatë përmes tubimeve, diskutimeve derë-më-derë, posterave, reklamave nëpër media dhe në media sociale me mesazhe lidhur me zhvillimin demokratik, integrimin në BE dhe NATO, marrëveshjen e re të demarkacionit të kufirit me Malin e Zi, luftën kundër korrupsionit, papunësinë, kujdesin shëndetësor, arsimin dhe liberalizimin e vizave. Platformat elektorale të shumicës së kandidatëve nuk ishin në dispozicion në faqet e tyre në internet. Shumica e kandidatëve kryesorë të zgjedhjeve u angazhuan në premtime të tepërta të fushatës, kryesisht në lidhje me sigurimin e shpejtë të udhëtimit pa viza dhe rritjen joreale të pensioneve dhe të pagave. Shumica e konkurrentëve përdorën metoda të ndryshme për ta plotësuar informacionin e pamjaftueshëm të votuesve nga administrata zgjedhore. Megjithatë, përpjekjet e tyre u drejtuan më shumë drejt bindjes së votuesve për të votuar për ta dhe më pak për edukimin të votuesve. Shumica e kandidatëve individualë përdorën fletushka të vogla ose karta informacioni për ta promovuar numrin e tyre në fletëvotim, shpesh së bashku me numrin e udhëheqësve të partive së tyre politike. Në zonat me shumicë serbe, Lista 'Srpska' ishte aktive në fushatën derë-më-derë dhe u ofroi votuesve udhëzime shumë të hollësishme se kë ta votojnë në secilën prej rajoneve të banuara nga serbët e Kosovës. Për shembull, në komunat veriore, votuesve u është thënë që të votojnë për kandidatët 1 deri në 5 në listën SL, ndërsa votuesve të Shtërpçës u është thënë që të votojnë për kandidatët 11 deri në 15.

Kuadri ligjor mund të jetë efektiv në sigurimin e barazisë së mundësive për të gjithë garuesit gjatë fushatës zgjedhore. Kodi i sjelljes për subjektet politike, mbështetësit dhe kandidatët e tyre e ndalon përdorimin e burimeve të zyrave publike për fushatë, si dhe kërcënimin e votuesve. Rregullorja e KQZ-së nr. 13/2013 për fushatën zgjedhore dhe njoftimin për ngjarjet politike i përcakton rregullat për vendosjen e materialeve zgjedhore dhe për mbajtjen e ngjarjeve publike, si dhe për pjesëmarrjen në fushatë të kategorive të caktuara të punonjësve të institucioneve publike. Subjektet politike në përgjithësi i respektuan rregullat e fushatës të përcaktuara në kuadrin ligjor. Megjithëse PZAP-i aplikoi gjoba për subjektet politike me shumë relativisht të madhe parash, një numër i konsiderueshëm për vepra të vogla që kanë të bëjnë me vendosjen e materialeve zgjedhore në zonat ku është e ndaluar vendosja, ose për reklamimin në internet, dhe vetëm pak gjoba për ushtrimin e presionit mbi votuesit, ose për vepra tjera më serioze.

Vëzhguesit e MVZ nga BE pranuan, kryesisht nga shoqëria civile, disa raporte për përdorimin e zyrove publike për qëllime fushate<sup>19</sup>. Pasi që Presidenti Thaçi i vizitoi shkollat fillore në Kosovë, partia rivale, LDK e akuzoi atë për fushatë për ish-partinë e tij, PDK dhe për shkeljen e kushtetutës<sup>20</sup>.

Disa rregulla të rëndësishme të fushatës siç janë ato që kanë të bëjnë me njoftimin e ngjarjeve politike adresohen vetëm në rregulloret e KQZ-së. Këto rregulla nuk janë tepër kufizuese, megjithatë, çështjet e tilla themelore që ndikojnë në të drejtën për të mbajtur tubim politik duhet të përcaktohen me ligj dhe nuk duhet t'i lihen KQZ-së për t'i rregulluar për çdo zgjedhje.

Vëzhguesit e MVZ nga BE morën raporte për blerjen e votave, duke i përfshirë zonat e banuara nga komunitetet më të vogla jo-shumicë. Praktika e blerjes së votave ndikon në lirinë e votuesve për ta formuar opinionin, që është në kundërshtim me parimin e votimit të lirë në standardet evropiane<sup>21</sup>.

Megjithëse fushata në shumicën e zonave të shqiptarëve të Kosovës ishte kryesisht e qetë, MVZ nga BE pranoi pretendime për presion dhe kërcënime ndaj votuesve dhe kandidatëve nga disa rajone<sup>22</sup>.

Për më tepër, mjedisi i fushatës u dëmtua nga një sjellje e frikësimit brenda komunitetit serb të Kosovës, duke i prekur veçanërisht partitë dhe kandidatët që nuk ishin të Listës Srpska. Kjo përfshinte presionin mbi kandidatët individualë për t'u tërhequr nga gara, pasuar nga masat që çuan në humbjen e vendit të punës të disa kandidatëve. Këto pretendime të përhapura rreth presionit dhe kërcënimeve të kandidatëve, të kombinuara me presionet dhe kërcënimet e votuesve, kishin ndikim negativ në fushatë në këto hapësira, duke shtuar mosbesimin ekzistues publik në procesin zgjedhor dhe ngritën shqetësime rreth aftësisë së votuesve për t'i hedhur votat e tyre pa frikë nga ndëshkimi. Pavarësisht nga natyra e gjerë e këtyre pretendimeve në disa komunitete, kandidatët e frikësuar nuk hezitonin që t'i paraqisnin ankesa zyrtare. Kishte shqetësime në këto komunitete se në mungesë të hetimit për këto pretendime, këto sjellje do të vazhdonin para mbajtjes së zgjedhjeve komunale më vonë gjatë këtij viti.

Kishte edhe incidente të dhunshme të izoluara, përfshirë një sulm me armë zjarri kundër zyrës së PKS në Leposaviq më 29 maj dhe një incident të dhunshëm që përfshinte përkrahësit e PKS dhe 'Lista Srpska' që çuan në ndalimin e përkohshëm të udhëheqësit të PKS-së më 4 qershor. Të gjitha këto incidente/zhvillime mund të ndikojnë në besimin e përgjithshëm në integritetin e procesit zgjedhor dhe ndikimin në lirinë e votuesve për ta formuar opinionin, që bie në kundërshtim me standardet evropiane<sup>23</sup>.

<sup>19</sup> Raportet për përdorimin e zyrrës publike në Viti; vetura me targa zyrtare në një tubim të PDK-së në Prizren dhe raporte për përdorimin e makinave zyrtare nëpër tubimet e LDK-së dhe PDK-së në Viti; komuna e Malishevës dyshohet se e favorizoi Nismën me rastin e ndarjes së hapësirës; Kryetari i LDK-së të Podujevës u përfshi në aktivitetet e fushatës gjatë orarit të punës;

<sup>20</sup> *Ndër të tjera*, neni 88 ia ndalon Presidentit që t'i ushtrojë funksionet e partive politike.

<sup>21</sup> Komisioni i Venecias, *Kodi i Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore, Raporti Shpjegues*, CDL-AD (2002) 23rev

<sup>22</sup> Vëzhguesit e MVZ nga BE raportuan *ndër të tjera* se punonjësit e institucioneve publike në Shtërpcë thuhet se u kishin kërkuar kartat e identifikimit, me indikacionin se ata duhet të ktheheshin vetëm pas ditës së zgjedhjeve, si dhe raste të frikësimit të votuesve në Novobërdë; LDK në Skenderaj tha se ata bëjnë fushatë vetëm nëpër shtëpia private dhe se nuk do të shfaqin postera për shkak të frikës nga presioni dhe frikësimi ndaj aktivistëve të partisë dhe votuesve nga PDK-ja; Lista Serbe në Viti tha se nuk ndiheshin të sigurt në organizimin e takimeve publike; PDK-ja në Ferizaj dyshohet se ka ushtruar presion ndaj nëpunësve civilë dhe mësuesve për ta votuar partinë. Një kandidat i Vetëvendosjes, si dhe komisionerët dhe vëzhguesit e partisë në Skenderaj dhe në Mitrovicën e Jugut u detyruan që të tërhiqeshin nga pozicionet e tyre.

<sup>23</sup> Shih: Komisioni i OSBE/ODIHR/Venecia, *Udhëzime të përbashkëta për parandalimin dhe reagimin ndaj keqpërdorimit të burimeve administrative gjatë proceseve zgjedhore*, 2016

Pjesëmarrja e grave në fushatë ka mbetur e ulët, ndërkohë që ekzistenca e grupeve të grave brenda disa partive politike nuk rezulton në ndonjë rol më të madh të grave në vendimmarrje. Kandidatet femra nuk kanë marrë mbështetje të barabartë për fushatat e tyre nga të gjitha subjektet politike. Paratë dhe mbulimi nga mediat ishin me prioritet për kandidatët meshkuj. Gratë rrallëherë ishin në pozita drejtuese në ekipet e fushatës<sup>24</sup>. Kandidatet femra rrallëherë folën në tubime dhe pjesëmarrja e grave në jetën publike pothuajse nuk diskutohej kurrë.

## VII. FINANCIMI I FUSHATËS

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligji Nr 03/L-174 për Financimin e Partive Politike dhe disa rregullore të KQZ-së për financimin e fushatës, sigurojnë kuadrin ligjor që rregullon të ardhurat dhe shpenzimet e subjekteve politike<sup>25</sup>. Kuadri ligjor parashikon limitet e shpenzimeve, kërkesat për publikim, procedurat e auditimit dhe gjobat. Burimet e financimit të subjekteve politike përfshijnë fonde publike si dhe donacione nga individë dhe persona juridik.

Ligji për Financimin e Partive Politike e rregullon ndarjen e fondeve publike për subjektet politike për fushatat zgjedhore, ndërsa rregulloret e KQZ-së shtojnë dispozita më të hollësishme për kufizimet e shpenzimeve, për publikim dhe për procedurat e auditimit. I njëjti ligj i përcakton kriteret sipas të cilave 90% e këtyre fondeve publike u ofrohen subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend, duke u bazuar në numrin e vendeve në legjislaturën e mëparshme, përderisa 10% ndahen proporcionalisht nga subjektet tjera politike të regjistruara dhe të certifikuara nga KQZ për të kandiduar në zgjedhje. Nuk u ndanë fonde publike për subjektet politike për këto zgjedhje legjislative, të cilat kufizuan mundësitë e fushatës për partitë më të vogla.

Rregulla Zgjedhore nr. 12/2013 e përcakton kufirin e shpenzimeve për secilin subjekt politik në 0.5 euro për votues të regjistruar. Në përputhje me ligjin, KQZ-ja njoftoi më 15 maj se shpenzimet maksimale të fushatës për subjekt politik ishin 942,753 euro. Ligji për financimin e partive politike i sqaron më tej burimet e të ardhurave, duke vendosur maksimumin e donacionit prej 2,000 euro në vit për personat fizik dhe 10,000 euro në vit për personat juridik.

Në përputhje me Rregullën Zgjedhore 12/2013, çdo subjekt politik i certifikuar për të marrë pjesë në zgjedhje duhet të paraqesë, jo më vonë se 45 ditë pas ditës së zgjedhjeve, raportin e fushatës për dhënien e informacioneve shpjeguese që mbulon periudhën që nga dita kur zgjedhjet u thirrën deri në ditën e zgjedhjeve<sup>26</sup>. Raporti u dorëzua nga subjektet politike pranë Zyrës së KQZ-së për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC). Standardet evropiane kërkojnë që raportet e financimit të fushatës të dorëzohen pranë autoriteteve përkatëse brenda një afati kohor prej jo më shumë se 30 ditë pas zgjedhjeve. Raportet e tilla duhet të kërkojnë jo vetëm për partinë në tërësi, por edhe për kandidatët individualë dhe listat e kandidatëve<sup>27</sup>. Që nga viti 2013, përgjegjësia për t'i audituar raportet qëndron me Kuvendin e Kosovës, i cili në mënyrë sistematike ka dështuar në përzgjedhjen e auditorëve, duke e lënë këtë kërkesë të rëndësishme të pazbatueshme. Raportet nga grupet e shoqërisë civile e kanë

<sup>24</sup> Ekipi i fushatës së koalicionit të LDK-së në Gjakovë.

<sup>25</sup> Rregulla Zgjedhore nr. 12/2013 për kufirin e shpenzimeve të fushatës dhe zbulimin financiar dhe Rregulloren e Zgjedhjeve nr. 14/2015 për financimin e subjekteve politike dhe sanksioneve.

<sup>26</sup> Neni 3.2 i Rregullores së Zgjedhjeve nr. 15/2013 për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe të Parakohshme

<sup>27</sup> Komisioni i Venecias dhe OSBE/ODIHR, *Udhëzimet për rregullimin e partive politike*, 2010

ndërlidhur këtë me mungesën e vullnetit politik midis partive politike të përfaqësuara në Kuvend<sup>28</sup>.

Efkti potencial pozitiv i kuadrit ligjor ekzistues është dëmtuar nga fushëveprimi i kufizuar i rishikimit financiar. Kjo përforcohet nga praktikat e brendshme të partive politike. Shumica nuk i publikojnë raportet gjithëpërfshirëse të fushatës në faqet e tyre në internet, duke iu referuar një dispozite ligjore që kërkon publikimin vetëm pasi që të jetë kryer auditimi. Për më tepër, mungesa e shqyrtimit ngritë pyetje rreth shpenzimeve përtej kufizimeve të përcaktuara me ligj, si dhe pranimit të donacioneve të paregjistruara, veçanërisht ato që u drejtohen kandidatëve individualë.

Në mungesë të monitorimit sistematik të financimit të fushatës nga subjekte të pavarura, si shoqëria civile dhe mekanizmat efektivë për mbikëqyrje nga institucionet publike, është e vështirë që të identifikohen mangësitë e raportimit financiar të fushatës përderisa obligimet ligjore përgjithësisht nuk zbatohen.

## VIII. MEDIAT

### A. Mjedisi medial

Kosova gëzon një mjedis pluralist dhe të gjallë mediatik. Burimet kryesore të informacionit janë televizioni së bashku me mediat online dhe ato sociale. Aktualisht ekzistojnë 71 kanale televizive dhe 83 radio-stacione, të cilat transmetohen përmes rrjeteve tokësore ose kabllore. Transmetuesi publik, Radio Televizioni i Kosovës (RTK), përbëhet nga katër kanale televizive dhe dy radio-stacione. Anëtarët e Bordit të RTK-së zgjidhen nga Kuvendi i Kosovës dhe transmetuesi publik mbështetet kryesisht nga buxheti i ndarë nga Kuvendi, i cili, sipas bashkëbiseduesve të MVZ nga BE, pengon pavarësinë e plotë të saj. Përveç kanalit televiziv publik, RTK1, janë edhe tri kanale private televizive të cilat kanë një audiencë të madhe: RTV21, Kohavision (KTV) dhe Klan Kosova.

Mediat online dhe ato sociale, duke përfutur nga depërtimi i lartë i internetit në Kosovë, janë një burim i rëndësishëm i informacionit, sidomos për të rinjtë, që kapë përqindje të madhe të popullsisë. Ndër mediat më të njohura të lajmeve në internet janë ‘gazetaexpress.com’ dhe ‘telegrafi.com’. Janë vetëm pesë media të shkruara të përditshme, me qarkullim shumë të kufizuar, por ato vazhdojnë që të kontribuojnë në nxitjen e debatit publik, sidomos e përditshmja më e respektuar ‘Koha Ditore’.

Peizazhi medial në Kosovë është i ndarë mes komuniteteve shqiptare dhe serbe. Kanali kryesor televiziv publik, RTK1, transmetohet në gjuhën shqipe, ndërsa *RTK2* transmeton në gjuhën serbe dhe në gjuhët tjera jo-shumicë përmes kabllit por nuk është i arritshëm në katër komunat veriore. Komunitetet serbe të Kosovës thuhet se mbështeten për informim tek transmetuesit lokalë në gjuhën serbe ose në kanalet kryesore televizive nga Serbia, të cilat janë lehtësisht të qasshme përmes rrjetit kabllor/TV.

### B. Kuadri ligjor për mediat

Legjislacioni siguron një kuadër të shëndoshë për lirinë e medias. Kushtetuta e Kosovës e garanton “lirinë dhe pluralizmin e mediave” dhe e ndalon censurën. Fyerja dhe shpifja nuk janë vepra penale dhe kuadri ligjor i përfshinë ligjet për mbrojtjen e burimeve të gazetarëve

<sup>28</sup> Komisioni Evropian i ka pasqyruar këto shqetësime në Raportin e Vendet 2015, nën temën e luftës kundër korrupsionit.

dhe dhënien e qasjes në informata publike<sup>29</sup>. Megjithatë, bashkëbiseduesit nga mediat raportuan se përderisa ata në përgjithësi mund ta ushtrojnë profesionin e tyre lirshëm, ende po ndodhin kërcënime ndaj gazetarëve dhe pavarësisht nga kuadri ligjor ekzistues, hetimi dhe ndjekja e tyre aktuale nga gjyqësori është ndonjëherë e ngadalshme dhe joefektive, veçanërisht në komunat veriore. Shoqata e Gazetarëve në Kosovë (SHGK) dhe Shoqata e Gazetarëve të Serbisë në Kosovë (SHGSK) janë organet kryesore që i përfaqësojnë interesat e gazetarëve kosovarë dhe u dëshmuar të jenë aktive edhe gjatë periudhës së zgjedhjeve<sup>30</sup>.

Mediat elektronike rregullohen me akte nënligjore të nxjerra nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), që është organ rregullator i mediave. Anëtarët e Bordit të KPM-së emërohen nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i vitit 2012 për Komisionin e Pavarur për Media i përcakton përgjegjësitë e tij, që përfshijnë rregullimin e frekuencave të transmetimit, lëshimin e licencave për transmetuesit publikë dhe privatë, krijimin dhe zbatimin e politikave të transmetimit si dhe sanksionimin e transmetuesve që nuk e respektojnë ligjin.

Mediat e shkruara dhe mediat online të lajmeve nuk kanë nevojë për licencë për të vepruar. Që nga viti 2005, mediat e shkruara e kanë miratuar vullnetarisht një Kod të përbashkët të sjelljes së shtypit dhe e kanë krijuar Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK) si trupin e tyre vetë-rregullues. Kohëve të fundit, duke e nxitur vetë-rregullimin e tyre, disa media në internet u bashkuan me Këshillin e Shtypit dhe tani përbëjnë shumicën e anëtarëve të tij<sup>31</sup>.

### C. Rregullimi i fushatës mediale

Mbulimi mediatik i fushatës zgjedhore rregullohet me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave, udhëzimet e KPM-së bazuar në Kapitullin VIII të LZP-së dhe Rregulloren e KPM-së për komunikimet audiovizive komerciale.

Ligji zgjedhor kërkon, *ndër të tjera*, që të gjitha mediat të sigurojnë se të gjitha subjektet politike të certifikuara mbulohen drejtë dhe paanshëm. Reklamimi i paguar është i lejuar pa kufij shpenzimi për garuesit, ndërsa mediat duhet të sigurojnë kushte të barabarta për të gjithë garuesit dhe çmimi i ngarkuar nuk duhet ta kalojë normën më të ulët për të njëjtën ‘kohë dhe ditë të javës’ që është aplikuar në gjashtë muajt e mëparshëm. Transmetuesit që pranojnë reklama me pagesë detyrohen që të ofrojnë kohë minimale të transmetimit falas për të gjitha subjektet politike të regjistruara për t’i përcjellë mesazhet e tyre, por ata mund të vendosin kur dhe në çfarë formati t’u mundësojnë atyre qasjen falas. Transmetuesit duhet të dorëzojnë në KPM në baza javore një ‘ditar’ me orarin e reklamave të paguara dhe kohën e lirë të transmetimit që i kushtohet secilit subjekt politik të certifikuar.

KPM-ja, e cila është përgjegjëse për mbikëqyrjen e pajtueshmërisë së mediave elektronike me rregulloret e mbulimit zgjedhor, luajti rol pasiv. Ajo nuk nxori ndonjë deklaratë publike ose vendim të shkruar lidhur me shkeljet ose ankesat e zbuluara gjatë fushatës zgjedhore. Në të vërtetë, asnjë vendim nuk mund të bëhet pa mbledhje të bordit dhe bordi nuk u takua asnjëherë gjatë periudhës së fushatës<sup>32</sup>. Në ditën e zgjedhjeve, Kryetari i KPM-së u paraqit si

<sup>29</sup> Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjeve (2012), Ligji për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë (2013), Ligji për Qasjen në Informata Publike (2010).

<sup>30</sup> Shoqata e Gazetarëve të Serbisë në Kosovë (SHKGSK) është degë e Shoqatës së Gazetarëve të Serbisë.

<sup>31</sup> Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës aktualisht përbëhet nga katër media të shkruara dhe 27 media të bazuara në internet.

<sup>32</sup> Komisioni i Pavarur për Media informoi MVZ të BE-së se i monitoroi 21 media audiovizive gjatë fushatës zgjedhore dhe se bordi i tij vendosi që të thërriste një mbledhje vetëm një herë lidhur me raportin përfundimtar të monitorimit të mediave. Deri më 1 korrik 2017, raporti ende nuk ishte publikuar dhe bordi i KPM-së nuk mbajti asnjë mbledhje.

mysafir në dy kanale televizive të cilat e shkelnin periudhën e heshtjes duke mbuluar dhe transmetuar deklarata nga anëtarët e partive politike, dhe ai nuk i dënoi shkeljet<sup>33</sup>.

Për më tepër, përderisa dispozitat ligjore kërkojnë vetëm mos-transmetimin e reklamave politike të paguara dhe programeve të sponsorizuara nga subjektet politike jashtë periudhës së fushatës zgjedhore, KPM-ja kërkoi që transmetuesit të mos i transmetojnë emisionet me diskutime politike e as të siguronin mbulim lajmesh të aktiviteteve të fushatës së hershme para fillimit të fushatës zgjedhore, e cila mund të kuptohet si një formë e panevojshme e kufizimit të lirisë së medias<sup>34</sup>.

#### D. Monitorimi i mediave nga MVZ i BE-së

Televizioni, mediat online dhe ato sociale ishin burimi kryesor i informacionit për votuesit. Afati kohor i shkurtër i fushatës zgjedhore ka bërë që subjektet kryesore politike t'i fillojnë aktivitetet e fushatës publike para fillimit të periudhës zyrtare të fushatës zgjedhore dhe transmetuesit i mbuluan ato në lajmet e tyre. Disa kanale televizive gjithashtu mbajtën emisione diskutimi dhe debate me përfaqësuesit politikë. Një kanal televiziv, Klan Kosova, gjatë një programi editorial ditor të fokusuar në zgjedhje, ndau disa orë për mbulim kryesisht të drejtpërdrejtë të tubimeve të koalicionit PAN<sup>35</sup>. Kjo duket të jetë një mënyrë për të ofruar hapësirë për fushatën e drejtpërdrejtë të një garuesi në vend se të sigurojë mbulim editorial të aktiviteteve të fushatës.

Gjatë fushatës zgjedhore, mediat elektronike mbuluan gjerësisht zgjedhjet në forma të ndryshme dhe abstenuan nga mesazhet nxitëse. Kanalet kryesore publike dhe private të televizionit raportuan ndërhyrje nga partitë politike, të cilat u përpoqën që të vendosnin kushte për debatet zgjedhore të cilat do t'u jepnin atyre trajtim të favorshëm, duke shkelur ligjin i cili kërkon mbulim të drejtë dhe të paanshëm të subjekteve politike të regjistruara. Këto përpjekje të raportuara kanë rezultuar në vështirësi për mediat në organizimin e debateve të drejta dhe gjithëpërfshirëse, të cilat kanë qenë një praktikë e vendosur në Kosovë në dëm të votuesve<sup>36</sup>.

Monitorimi i mediave nga MVZ i BE-së tregoi se kanalet kryesore televizive ofruan mbulim mjaft të balancuar dhe kryesisht neutral në tonin e lajmeve gjatë fushatës zgjedhore<sup>37</sup>. Kanali televiziv publik *RTK1* siguroi mbulim të balancuar në lajme me pothuajse të njëjtën hapësirë për koalicionet PAN dhe LAA, respektivisht 35 dhe 34 për qind, dhe më pak mbulim për

<sup>33</sup> Kryetari i KPM-së mori pjesë si mysafir në programet e drejtpërdrejta gjatë ditës së zgjedhjeve në RTV21 dhe Klan Kosova. Të dyja kanalet televizive në të njëjtën ditë shkëlën nenin 52.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme duke i mbuluar konferencat e drejtpërdrejta për shtyp të anëtarëve të partisë.

<sup>34</sup> Neni 2.2 dhe neni 14.5 i Rregullores për komunikimet audiovizuale komerciale, KPM-2016/02, i ndalojnë reklamën dhe programet politike të paguara respektivisht të sponsorizuara nga partitë politike jashtë periudhës së fushatës zgjedhore. KPM-ja nuk dha asnjë referencë në dispozitat tjera ligjore të cilat e kufizojnë mbulimin editorial të zhvillimeve politike dhe diskutimeve përpara fushatës zgjedhore. Transmetuesit nuk e kanë respektuar këtë kërkesë të veçantë të KPM-së.

<sup>35</sup> Nga data 22 deri më 30 maj 2017 programi i përditshëm i Klan Kosova TV "Zona Zgjedhore" transmetoi 8 orë e 52 minuta të ngjarjeve më të shpeshta të fushatës PDK dhe AAK.

<sup>36</sup> Kanalet televizive raportuan se fillimisht PAN u përpoq që të impononte kushte që i jepnin përfaqësim më të lartë, për kah numri i përfaqësuesve të ftuar apo kohëzgjatja, sesa subjektet tjera politike të regjistruara. Pas refuzimit të kanaleve televizive, dy parti nga PAN, AAK dhe NISMA, vendosën që të marrin pjesë në debate, ndërsa partia kryesore e koalicionit, PDK, nuk mori pjesë. Disa kanale televizive i zhvilluan debatet zgjedhore siç ishte planifikuar, ndërsa të tjerat zgjedhën intervista të ndara me garuesit. Me një vërejtje pozitive, KTV-ja ishte i vetmi kanal televiziv në gjuhën shqipe që organizonte dhe transmetonte debat zgjedhor midis partive politike serbe të Kosovës.

<sup>37</sup> MVZ nga BE zhvilloi gjatë periudhës së fushatës parazgjedhore, nga 22 deri më 30 maj 2017, një monitorim cilësor të katër kanaleve televizive (RTK1, RTV21, KTV dhe Klan Kosova TV) nga ora 18:00 deri në 24:00. Gjatë fushatës zgjedhore, 31 maj - 9 qershor 2017, monitorim sasior dhe cilësor të mediave RTK1, RTK2, RTV21, KTV dhe Klan Kosova nga ora 17:00 deri në ora 01:00, si dhe emisionin kryesor televiziv të TV Most dhe TV Puls. Një monitorim cilësor i një mostre të mediave online të lajmeve dhe mediave sociale (faqet e Facebook) u zhvillua gjithashtu gjatë fushatës zgjedhore.



Vetëvendosje me 24 për qind. Kanali televiziv privat RTV21 ishte më i balancuar në lajmet e tij me 31 për qind për koalicionin LAA, 29 për qind për koalicionin e PAN dhe 28 për qind për Vetëvendosje. KTV-ja, e cila ofroi më pak mbulim lajmesh të fushatës zgjedhore krahasuar me kanalet tjera televizive, ishte gjithashtu mjaft e balancuar, duke i kushtuar koalicionit PAN 32 për qind, 24 për qind për LAA dhe 23 për qind për Vetëvendosje të mbulimit të lajmeve. Për dallim, TV kabllor 'Klan Kosova' shfaqti një paragjykim të qartë në favor të PAN, i cili përfitoi 46 për qind e mbulimit të lajmeve, dhe 28 dhe 19 për qind për koalicionin LAA dhe Vetëvendosje.

Televizioni publik RTK2 ofroi një mbulim shumë të kufizuar, por të balancuar të lajmeve të partive politike serbe dhe të partive tjera jo-shumicë, duke i kushtuar shumicën e mbulimit të saj dy partive politike serbe të Kosovës, Lista Srpska dhe NDS, me 33 dhe 25 përqind respektivisht partisë politike boshnjake BSDAK me 25 për qind. Për dallim, dy kanalet televizive lokale në gjuhën serbe TV Most dhe TV Puls pothuajse ekskluzivisht e mbulonin Listën Srpska, duke i ofruar kësaj partie 64 dhe 63 për qind të mbulimit të tyre të lajmeve; partitë tjera serbe të Kosovës morën mbulim minimal, gjë që ishte gjithashtu negative në ton.

Përveç spoteve të reklamave politike të paguara, garuesit kryesorë përfitonin nga një mangësi në ligj që u lejon kanaleve televizive që të transmetojnë programe të sponsorizuara nga subjektet politike pa kufizime. Kjo rezultoi në atë se subjektet kryesore politike blinin kohë transmetimi në kanalet televizive për t'i transmetuar ngjarjet e tyre të fushatës. Në disa raste, mbulimi total i paguar përbënte gjysmë ose më shumë nga mbulimi i përgjithshëm i ofruar nga kanalet televizive: në KTV 57 për qind e totalit të mbulimit të zgjedhjeve u pagua dhe në Klan Kosova ishte 47 për qind. Ekipi i monitorimit të medias së MVZ nga BE vërejti shkelje të transmetuesve duke i monitoruar reklamat politike të paguara para dhe gjatë fushatës zgjedhore, si dhe shkeljet e periudhës së heshtjes<sup>38</sup>.

Mediat e lajmeve online e mbuluan gjerësisht fushatën zgjedhore; megjithatë, shumica e mbulimit u bazua në informatat e mbledhur nga agjencitë e lajmeve, burimet e mediave tjera, njoftimet për shtyp të partive politike dhe faqet e Facebook-ut, me raportim minimal gazetaresk të prodhuar nga redaksitë e mediave online. Disa media online morën një qëndrim të qartë në favor të disa garuesve. Faqja e internetit më popullore në Kosovë, GazetaExpress, dy ditë para ditës së zgjedhjeve, e mbështeti publikisht kandidatin për kryeministër të koalicionit PAN.

Mediat sociale luajtën një rol të rëndësishëm si burim informacioni gjatë fushatës zgjedhore<sup>39</sup>. Për shembull, mediat online të takuara nga MVZ nga BE, pranuan se shumica e trafikut të tyre u gjenerua nga faqet e tyre në Facebook. Në të vërtetë, Facebook siguroi një platformë të re për mediat e vjetra dhe të reja (kanalet televizive, mediat e shtypura dhe ato në internet), të cilat gjithashtu e shfrytëzuan këtë medium social për t'i mbuluar zgjedhjet duke shfrytëzuar formate të ndryshme duke filluar nga videot në Facebook dhe videot e drejtpërdrejta e gjer tek lidhjet në përmbajtje të jashtme siç janë artikujt apo videot e publikuara fillimisht në internet, media të shtypura dhe kanale televizive. Videot e drejtpërdrejta në Facebook të ngjarjeve të fushatës ose të emisioneve të diskutimeve dhe

<sup>38</sup> Shkeljet e ligjeve përfshinin transmetimin e reklamave politike të paguara (dhe pa i shenjuarsit të tilla) para dhe gjatë fushatës zgjedhore, transmetimin e reklamave politike të paguara pa i shenjuar ato si të paguara dhe as duke treguar se kush ka paguar për to, dhe paraqitja e fëmijëve në spotet e paguara politike.

<sup>39</sup> Deri më 30 qershor 2016 ishin 860,000 përdorues të Facebook në Kosovë, 45.4% të popullsisë. Burimi: <http://www.internetworldstats.com/stats4.htm>. Twitter ka një numër shumë të kufizuar të përdoruesve dhe nuk luajti rol gjatë këtyre zgjedhjeve.

debateve zgjedhore ishin formati që krijoi përfshirjen më të lartë të publikut<sup>40</sup>. Monitorimi i MVZ nga BE vërejti vetëm disa raste të izoluar të faqeve të internetit të lajmeve dhe të faqeve të Facebook-ut të krijuara për të përhapur lajme të rreme dhe mashtruese, duke e përfshirë një ‘exit poll’ të rremë në ditën e zgjedhjeve.

Në pajtim me ligjin, transmetuesi publik i transmetoi spotet edukative të votuesve të siguruar nga KQZ-ja në kanalën e parë televiziv RTK1, në gjuhën shqipe dhe në transmetimet e RTK2 në gjuhën serbe dhe në gjuhët jo-shumicë. Sidoqoftë, RTK2 nuk është i arritshëm në komunat veriore të serbëve, të cilat nuk kanë përfituar nga spotet edukative të votuesve të KQZ-së<sup>41</sup>. Gjatë fushatës zgjedhore, transmetuesit kryesorë të monitoruar ofruan në programet e tyre editoriale qasje dhe mbulim shumë të kufizuar për kandidatet femra: nga mbulimi i përgjithshëm i ofruar kandidatëve, vetëm 10 për qind iu kushtua grave kandidatë<sup>42</sup>

## IX. DITA E ZGJEDHJEVE

Dita e zgjedhjeve ishte e qetë, pa incidente të mëdha të regjistruara nga vëzhguesit e MVZ nga BE. Vendvotimet në përgjithësi u hapën në kohë dhe ishin të përgatitura për votim. Procedurat e hapjes kryesisht u ndoqën dhe hapja u vlerësua pozitivisht në të gjitha vendvotimet e vëzhguara.

Në përgjithësi, procesi i votimit u vlerësua si i mirë ose shumë i mirë në 97% të vendvotimeve të vëzhguara. Megjithatë, disa subjekte politike vendosën më shumë se dy vëzhgues të akredituar në një numër të konsiderueshëm vendvotimesh, gjë që e shkelë ligjin e zgjedhjeve<sup>43</sup>. Në disa raste, kjo mund të ketë pasur ndikim negativ në lirinë e votuesit nga presioni gjatë votimit. Përveç kësaj, disa parti politike i vendosën mbështetësit e tyre si vëzhgues të akredituar të OJQ-ve, duke e përkeqësuar më tej problemin. Kjo thuhet se ishte rasti i OJQ-së të panjohur ‘Instituti Rajonal për Demokraci, të Drejtat e Njeriut dhe Studime Politike’ (shih më poshtë, Vëzhguesit e Zgjedhjeve).

Ndërsa procedurat e votimit u zbatuan në përgjithësi, vëzhguesit e MVZ nga BE vunë në dukje shumë raste të votimit familjar (në 18% të vëzhgimeve), nganjëherë të kombinuara me votim në emër të tjetrit (4% të vëzhgimeve). Disa votues u deshtë që të largohen nga vendvotimi në 16% të vendvotimeve të vëzhguara, kryesisht për shkak të daljes në vendvotimin e gabuar. Në mënyrë domethënëse, rreth 39% e qendrave të votimit nuk ishin të qasshme për votuesit me aftësi të kufizuara. Gjatë ditës së zgjedhjeve, heshtja e fushatës ishte shkelur nga disa kanale televizive private që transmetonin deklaratatë të anëtarëve të partisë politike.

Numërimi i votave u vlerësua më negativisht nga vëzhguesit e MVZ nga BE, kryesisht për shkak të KVV-ve që jo gjithmonë i ndiqnin procedurat e numërimit, që duket se vjen për shkak të kompleksitetit të procesit të kombinuar me mungesën e trajnimit adekuat, duke çuar në vështirësi për disa KVV në plotësimin e protokolleve të rezultateve. Në disa raste, vëzhguesit e akredituar janë parë duke ndërhyrë në këtë proces.

<sup>40</sup> Me “përfshirje” i referohemi shumës së numrit të bashkëveprimeve, siç janë “pëlqimet”, komentet dhe veprimet nga publiku.

<sup>41</sup> Neni 47.2 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme kërkon që transmetuesi publik ta transmetojë pa pagesë materialin edukativ të votuesve të siguruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

<sup>42</sup> Mbulimi i kandidatëve sipas gjinisë në RTK1, RTV21, KTV dhe Klan Kosova gjatë fushatës zgjedhore në programet e tyre editoriale.

<sup>43</sup> Koalicioni LAA dhe koalicioni PAN kishin më shumë se dy vëzhgues të akredituar në 17% dhe 27% të vendvotimeve, respektivisht.

KQZ-ja raportoi daljen në zgjedhje prej 41% dhe filloi që t'i publikojë rezultatet preliminare për vendvotime sipas subjekteve politike brenda orëve të mbylljes, duke e rritur kështu transparencën e rezultateve.

Vëzhguesit e MVZ nga BE e përcollën marrjen e materialeve zgjedhore në 16 komuna dhe e vlerësuan procesin pozitivisht.

## X. PROCEDURAT PAS DITËS SË ZGJEDHJEVE

### A. Publikimi i të dhënave të parakohshme të zgjedhjeve ("K-Vote")

KQZ-ja i publikoi në faqen e saj në internet të dhënat e hershme duke filluar me pjesëmarrjen e votuesve tri herë gjatë ditës së zgjedhjeve dhe rezultatet e hershme të listave të subjekteve politike në mbrëmjen e zgjedhjeve. Kjo u bë përmes K-Vote, një sistem i raportimit të të dhënave me anë të të cilit formularët e rezultateve të vendvotimeve u regjistruan nga agjentët e KQZ-së përmes tabletëve në çdo qendër të votimit. Ky sistem e ka rritur transparencën dhe u ka mundësuar votuesve që të marrin informata të besueshme për tendencat kryesore të rezultateve të zgjedhjeve. Sistemi, megjithatë, hasi në vështirësi teknike, thuhet për shkak të firewall-it dhe interesimit të lartë të publikut. Rezultatet preliminare nuk ishin të qasshme për një orë gjatë natës së zgjedhjeve dhe vazhduan me qasje të vështirë në ditët në vijim<sup>44</sup>.

Sipas këtyre rezultateve të hershme, koalicioni PAN ishte në krye me rreth 34% të votave dhe priste 39 ulëse. Vetëvendosje doli e dyta me 27% të votave dhe potencialisht 31 ulëse, ndërsa koalicioni LAA doli i treti me më shumë se 25% të votave dhe 30 ulëse potenciale. Në anën serbëve të Kosovës, Lista Srpska mori pak nën 6% të votave dhe do të siguronte nëntë ulëse, ndërsa Partia e Pavarur Liberale (SLS) do ta siguronte një vend.

Pasi që këto rezultate të hershme nuk i përfshinin numrin e votave preferenciale për kandidatët në lista, nuk ishte e qartë se sa vende do t'i merrnin secila nga partitë që konkurronin në koalicionet PAN dhe LAA. Disa faqe interneti dhe parti politike shpërndanin informatat e tyre në lidhje me rezultatet e preferencave të kandidatëve nga disa komuna<sup>45</sup>.

Mediat dhe hisedarët komentuan rreth numrit të madh të fletëvotimeve të pavlefshme, që sipas të dhënave të K-Vote arriti në 52,522, ose 7 për qind, një përqindje më e lartë në krahasim me zgjedhjet e mëparshme parlamentare të vitit 2014<sup>46</sup>. KQZ-ja kërkoi nga Qendra e Numërimit dhe e Rezultateve një analizë të hollësishme pas-zgjedhore të fletëvotimeve të pavlefshme. Më vonë doli se disa nga fletëvotimet e pavlefshme të raportuara nga K-Vote rezultuan nga plotësimi i gabuar i protokolleve të rezultateve.

### B. Qendra e Numërimit dhe e Rezultateve

Tabulimi i rezultateve zyrtare, duke i përfshirë votat preferenciale për kandidatët, bëhet vetëm në Qendrën e Numërimit dhe e Rezultateve<sup>47</sup> (QNR), lokacionin qendror ku numërohen votat me kusht, votat e personave me nevoja të veçanta (VPNV), votat me postë nga Kosova dhe çdo fletëvotim i rregullt siç kërkohet nga KQZ-ja. Këtu auditohen dhe

<sup>44</sup> KQZ-ja i publikoi rezultatet e hershme për 2,487 prej 2,490 vendvotimeve, ndërsa për tri vendvotime nuk ka të dhëna, dhe MVZ nga BE iu shpjegua se një vendvotim PS 2042a/28r nuk i kishte futur të dhënat në K-votim dhe u rinumërua më vonë, ndërsa i dyti ishte vendvotimi mobil PS 1119b/01d pa votues dhe i treti PS 2063a/01d nuk ishte funksional.

<sup>45</sup> Partitë politike mblodhën të dhënat e FRK përmes vëzhguesve të tyre në vendvotime ose nga burimet tjera.

<sup>46</sup> Në zgjedhjet e vitit 2014 numri i fletëvotimeve të pavlefshme të raportuara nga KQZ ishte 30,725 (4%) dhe 4,842 fletëvotime të zbrazëta (0,6%).

<sup>47</sup> Qendra e Numërimit dhe e Rezultateve është e vendosur në një depo në një zonë industriale pranë Prishtinës.

tabulohen formularët e rezultateve nga të gjitha vendvotimet dhe përpilohen rezultatet përfundimtare.

**Pranimi:** Më 12 qershor, materialet zgjedhore nga mbarë Kosova arritën në QNR. Hapi i parë i procesit të pranimit ishte që të kontrollohej nëse çdo kuti votimi e përmbante materialin e kërkuar siç është Libri i Votimit, Formulari i Përputhjes së Rezultateve (FPR), Formulari i Rezultateve të Kandidatëve (FRK), Lista e Përfundimtare e Votuesve (LPV) si dhe Lista e Votuesve me Kusht (LVK) dhe Zarfet e Fletëvotimeve me Kushte (ZFK) në rastin e vendvotimeve të dyfishta. Nëse gjithçka ishte e kompletuar dhe në rregull, kutia e votimit dërgohej në zonën e magazinimit, librat e votimit dërgoheshin për arkivim dhe FRP dhe FRK dërgoheshin për fazën e skanimit dhe të futjes së të dhënave. Nëse disa materiale mungonin ose formularët nuk ishin plotësuar, kutitë e votimit dërgoheshin në karantinë. Nga gjithsej 2,490 vendvotime, 189 u dërguan në karantinë në fazën e pranimit për shkak të numrave të gabuar të vulave, ose materialeve jo të plota ose të humbura. KQZ-ja vendosi më 15 qershor që t'i rinumërojë 30 prej këtyre vendvotimeve dhe t'i zhvlerësojë 391 fletëvotime me kusht nga 19 vendvotime të dyfishta<sup>48</sup>, ndërsa 140 kutitë e mbetura të votimit u përpunuan si të rregullta.

**Skanimi dhe futja e të dhënave:** Pas fazës së pranimit, QNR i skanoi format e rezultateve (FPR-të, FRK-të) nga vendvotimet dhe votuesit e skanuar që i nënshkruan listat e votuesve. Rezultatet nga FPR-të dhe FRK-të ishin futur paralelisht dyfish ku mbikëqyrësit i kontrollonin rezultatet nga të dyja futjet e të dhënave. Ritmi ishte tepër i ngadaltë dhe shkalla e gabimeve teknike ishte veçanërisht e lartë ku në 84% të FRK-ve doli se kishte mospërputhje në mes të dy futjeve të të dhënave.

**Auditimi:** Në total disa qindra vendvotime u dërguan në auditim në një moment për shkak të mospërputhjes së numrave në formularët e rezultateve dhe ato 398 vendvotime nuk e kaluan auditimin dhe u rinumëruan<sup>49</sup>. Duket se komunikimi ndërmjet QNR-së dhe KQZ-së nuk është i qartë dhe në veçanti duket se ka kritere të paqarta për të vendosur nëse rinumërimi duhet të jetë i pjesshëm (vetëm votat për subjektin politik) ose i përgjithshëm ose në cilat raste niveli i tolerancës mund të rritet dhe si duhet të zbatohet saktësisht nga QNR-ja. Numri i përgjithshëm i vendvotimeve të përmendura në atë fazë ishte 425 ose 17% e të gjitha vendvotimeve. Proceset e ankesave dhe parashtresave rezultuan me rinumërim të mëtejshme të urdhëruara nga PZAP-i: 117 më 3 korrik dhe 23 më 6 korrik (shih më poshtë - Ankesat dhe Parashtresat).

Për ta rritur transparencën e këtyre proceseve të numërimit dhe rinumërimit, KQZ-ja vendosi që ta rrisë numrin e vëzhguesve të lejuar për subjektet politike në QNR dhe më 17 qershor filloi që t'i publikojë në faqen e vet në internet formularët e skanuar të rezultateve (FPR-të, FRK-të) nga vendvotimet<sup>50</sup>.

**Votimi jashtë Kosovës dhe me kusht:** Pas përfundimit të rinumërimit të vendvotimeve më 23 qershor, QNR filloi numërimin e 5,949 fletëvotimeve me postë nga jashtë Kosova. Rezultatet e numërimit të votave me postë u postuan në murin e QNR-së dhe ky numërim u përfundua për dy ditë.

Pas pushimit të fundjavës së Bajramit, QNR-ja vazhdoi me përgatitjet për numërimin e 25.488 fletëvotimeve me kusht dhe 1.939 votave të personave me nevoja të veçanta (VPNV).

<sup>48</sup> Arsytet pse ishin të pavlefshme ishin kryesisht mungesa e nënshkrimeve të votuesve në listën e votuesve ose mospërputhjet mes numrit të fletëvotimeve me kusht dhe numrit të nënshkrimeve në listën e votuesve me kusht.

<sup>49</sup> KQZ-ja vendosi që t'i rinumërojë 115 vendvotime më 17 qershor, 280 vendvotime më 19 qershor (vendimi i KQZ-së 1112-2017) dhe tri vendvotime më 23 qershor (vendimi i KQZ-së 1137-2017).

<sup>50</sup> <http://www.kqz-ks.org/en/news/Details/324>

Procesi i verifikimit dhe i konfirmimit të fletëvotimeve me kusht u dëmtua nga mungesa e transparencës, konsistencës dhe saktësisë sa i përket rregullave për identifikimin e votuesve me kusht dhe rregullave për vendosjen e të drejtës së tyre.

Kreu i QNR-së deklaroi se janë dy kategori të votuesve me kusht, të cilave u janë mohuar fletëvotimet: votuesit që ose kishin votuar me fletëvotim të rregullt ose fletëvotim tjetër me kusht, ose në shumicën e rasteve ishin votues që nuk u gjetën në listën përfundimtare të votuesve. Arsyeja për këtë ishte se ata nuk e kishin dhënë numrin e identifikimit në zarfin e votimit me kusht (ZVK), që është njëra nga katër informatat që votuesi duhet t'i sigurojë: emrin, mbiemrin, datën e lindjes dhe numrin unik të identifikimit<sup>51</sup>.

Shumë nga fletëvotimet me kusht u refuzuan nga komunat me shumicë serbe të komunitetit serb të Novobërdës (68,3% të refuzuara), Zveçanit (54%), Mitrovicës së veriut: (49,4%), Leposaviqit (41,9% të refuzuara), Zubin Potokut (37%) dhe Parteshit (30,3%). Votat me kusht janë përzier së bashku me Votat e Personave me Nevoja të Veçanta në dengje prej 150 deri 250 vota nga e njëjta komunë. Dengjet u numëruan në tavolina të numërimit dhe formularët e rezultateve për deng u postuan në muret e QNR-së dhe u futën në sistemin e bazës së të dhënave.

Shpallja e rezultateve: Pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve me kusht më 28 qershor, QNR-ja e përpiloi tabelën përfundimtare të rezultateve për subjektet politike dhe kandidatët preferencial së bashku me ndarjen e vendeve për subjektet dhe kandidatët.

Më 29 qershor 2017, QNR-ja i dorëzoi të dhënat e rezultateve përfundimtare pranë KQZ-së dhe disa anëtarë të KQZ-së e kritikuan atë që panë si mospërputhje të dukshme në numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve të pavlefshme, fletëvotimeve të papërdorura si dhe numrin total të votuesve që kishin votuar me kusht, VPNV ose fletëvotimet jashtë Kosovës. KQZ-ja i kërkoi QNR-së që ta kontrollojë konsistencën e shifrave dhe vendosi të njëjtën ditë që t'i shpallë rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për të gjitha subjektet politike dhe kandidatët e zgjedhur. Për ta rritur transparencën, KQZ-ja menjëherë i publikoi të gjitha rezultatet e zgjedhjeve në faqen e saj të internetit duke i përfshirë numrat e tabulimeve të votave për kandidatët e 26 subjekteve politike për çdo vendvotim. KQZ-ja gjithashtu i publikoi formularët e skanuar të rezultateve (FPR-të, FRK-të) nga 425 rinumërimet, formularët e rezultateve të votuesve jashtë Kosovës dhe formularët e rezultateve me kusht.

Në përgjithësi, Qendra e Numërimit dhe e Rezultateve ofron një nivel shtesë të nevojshëm të shoshitjes mbi procesin zgjedhor. Ndonëse mbetet i domosdoshëm spastrimi i të dhënave rreth vendvotimeve, procesi i QNR-së është i paefektshëm, disa nga metodat e saj marrin tepër kohë dhe disa pjesë të procesit nuk kanë saktësi dhe transparencë, veçanërisht në trajtimin e fletëvotimeve me kusht.

---

<sup>51</sup> Votuesit me kusht duhet t'i shkruajnë katër informata mbi zarfet e jashtme të fletëvotimeve me kusht (ZFK): emri, mbiemri, numri i identifikimit dhe data e lindjes. Në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, ZVK-të u konsideruan të vlefshme përderisa:

- (1) mund të përcaktohej identiteti i personit;
- (2) e drejta e personit mund të konstatohet në bazë të pranisë në listën përfundimtare të votuesve; dhe
- (3) fletëvotimi me kusht ishte i pranueshëm sepse votuesi nuk kishte votuar me fletëvotim të rregullt ose me ndonjë tjetër fletëvotim me kusht, ose me fletëvotim nga jashtë Kosova.

Doracakut i procedurave të QNR-së parasheh se për qëllimin e hapit të parë, identifikimi i votuesit, QNR-ja duhet të sigurojë se zarfi duhet ta përmbajë të paktën emrin dhe mbiemrin dhe pastaj numrin ose datën e lindjes. Nëse numri i identifikimit nuk është dhënë nga votuesi ose nuk është gjetur në bazën e të dhënave, QNR-ja ende mund të përpiqet që ta konstatojë identitetin e votuesit me kusht në bazë të emrit, mbiemrit dhe datës së lindjes.

## XI. XI. KONTESTET ZGJEDHORE

### A. Parashtrës dhe ankesat

Ankues mund të jetë çdo person, fizik ose juridik, i cili ka interes ligjor në çështje, ose të drejtat e të cilit lidhur me procesin zgjedhor mendohet se janë shkelur. Këta janë votuesit, subjektet politike, anëtarët e KVV-ve ose KKZ-ve ose vëzhguesit e partive politike. PZAP pranon ankesa edhe nga OJQ-të.

Ankuesit i kanë 24 orë kohë pas mbylljes së vendotimeve për të parashtruar ankesa lidhur me procesin e votimit dhe 24 orë nga shkelja e supozuar për ato që kanë të bëjnë me periudhën e heshtjes dhe numërimin dhe tabelimin. Sidoqoftë, PZAP i ka 72 orë nga pranimi i ankesës për të sjell vendimin, i cili mund të apelohe në Gjykatën Supreme brenda 24 orësh.

#### Deri në publikimin e rezultateve të zgjedhjeve

Deri në publikimin e rezultateve nga KQZ me 29 qershor, Paneli Zgjedhor për Parashtrës dhe Ankesa (PZAP) kishte pranuar gjithsej 354 parashtrës dhe ankesa. 141 prej tyre ishin miratuar, 16 ishin tërhequr dhe të tjerat ishin refuzuar duke u bazuar në formë ose në materie. Për pesë nga parashtrës dhe ankesat e refuzuara janë parashtruar ankesa në Gjykatën Supreme, ku vendimet e PZAP-së kryesisht janë konfirmuar (një ishte ndryshuar në formë por ishte konfirmuar në materie).

Gjithsej ishin 289 ankesa që në një mënyrë ose tjetër kishin të bënin me fushatën: 20 ishin refuzuar për shkak se ishin parashtruar gjatë periudhës para fushatës (dhe ligji dhe rregullorja përkatëse e KQZ-së dhe kodi i sjelljes e rregullojnë vetëm sjelljen e subjekteve politike gjatë periudhës zyrtare të fushatës); 181 ankesa lidhur me vet fushatën zgjedhore dhe 88 lidhur me shkeljet e heshtjes parazgjedhore. 151 ankesa ishin parashtruar nga OJQ-të, pjesa tjetër nga subjektet politike. PZAP ka shqiptuar gjopa në shumën prej 357,200.00 Euro për shkeljet në fushatë, shumica për shkelje relativisht të vogla (vendosje të posterëve në vende të gabuara dhe të ngjashme).

Megjithatë, në rastin e ankesave të parashtruara lidhur me shkeljet gjatë numërimit brenda afatit kohor prej 24 orësh pas shkeljes së supozuar, PZAP i refuzoi këto ankesa si të palejueshme, kryesisht duke u sqaruar ankuesve që të kthehen pas publikimit të rezultateve, nëse do të ishin prapë të pakënaqur. Është e mundur që kjo qasje t'i ketë bërë disa ankesa të planifikuara të panevojshme - prej tetë ankesave të refuzuara si të palejueshme menjëherë pas numërimit, vetëm tri sosh ishin parashtruar sërish pas publikimit të rezultateve. Por kjo ka çuar edhe në grumbullimin e 66 ankesave që ishin parashtruar 24 orë pas publikimit të rezultateve nga KQZ. Për më tepër, trajtimi i këtyre ankesave menjëherë duke zbuluar kështu disa prej manipulimeve gjatë numërimit mund të ngrite vetëdijen për kontrolle të tjera në QNR, po të ishte bërë menjëherë pas ditës së zgjedhjeve. PZAP argumenton se shtyrja e ankesave deri pas publikimit të rezultateve përfundimtare tregon se ankuesit kanë përgatitur më mirë ankesat. Kjo është e vërtetë, pasi që në këtë mënyrë ata, për shembull, mund të përfshinin në argumentet e tyre formularët e skanuar të rezultateve. Sidoqoftë, neni 119.1 i LZP i ndryshuar thekson se personi të drejtat e të cilit janë shkelur sa i përket procesit zgjedhor mund të paraqesë ankesë në PZAP brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit - kështu që ndonëse mund të argumentohet se ankesat duhet pranuar pas publikimit të rezultateve përfundimtare, ato që ishin parashtruar menjëherë pas ditës së zgjedhjeve nuk është dashur të refuzoheshin si të palejueshme.

### Ankesat e parashtruara në PZAP pas publikimit të rezultateve

Pas publikimit të rezultateve janë parashtruar edhe 66 ankesa të tjera dhe në QNR janë zhvilluar procedurat hetimore nga PZAP lidhur me 23 ankesa. Prej 66 ankesave, PZAP miratoi 40 si të bazuara dhe refuzoi 26 si të pabazuara ose të parashtruara pas afatit.

Të 40 ankesat e bazuara bën që PZAP të urdhërojë rinumërimin e 117 kutive të votimit, 15 plotësisht dhe 102 pjesërisht. Rinumërimi u zhvillua me 3-4 korrik në QNR në praninë e vëzhguesve të subjekteve politike. Ato u vlerësuan si të mira dhe pa kundërthënie.

Rinumërimet çuan në disa ndryshime në shpërndarjen e mandateve:

- Në kuadër të Listës Serbe, Slavko Simic, lideri i partisë e mori mandatin me 12,603 vota nga Branimir Stojanovic me 12,464 vota.
- Në koalicionin LAA, Naser Osmani (LDK) e fitoi mandatin me 7,350 vota nga Imet Rrahmani me 7,272 vota.
- Në listën e KDTP, Fikrim Damka e fitoi mandatin me 2,980 vota nga Mahir Jagcilar me 2,928 vota.

PZAP i zgjodhi ankesat brenda afateve ligjore<sup>52</sup>. Për dallim nga gjobat e konsiderueshme (357,200.00 euro) që ju shqiptuan subjekteve politike për shkelje (relativisht të vogla, siç janë vendosja e posterëve në vendet e paautorizuara) të rregullave të fushatës, për ankesat lidhur me ditën e zgjedhjeve (votimi dhe numërimi) nuk u shqiptua asnjë gjobë ndaj individëve. Në shqyrtimin e ankesave, PZAP kryesisht ka qasje formale dhe nuk kërkon dëshmi në mënyrë proaktive. Ligji nuk e obligon Panelin që të bëjë këtë në secilin rast, por PZAP vepron sipas ligjit dhe rregulloreve të veta të brendshme, duke ndjekur procedurat dhe respektuar afatet kohore, që janë të shkurtra, edhe më shumë se zakonisht me ankesat pas-zgjedhore në mënyrë që të mos vonohet certifikimi i rezultateve. Edhe pse shkurtimisht, baza ligjore dhe arsyetimi në vendime, u dhanë, si dhe vendimet u publikuan në faqen e internetit të PZAP-së, në kohën e akumulimit të presionit për vendim-marrje me një vonesë.

Një ankesë që ka të bëjë me rreth 1, 200 vota me kusht është refuzuar si e pabazë nga PZAP. Ankuesi në mënyrë të saktë kishte vënë në dukje se rregullat e QNR-së për verifikimin e votave me kusht nuk ishin respektuar: rregullat thonë se emri dhe mbiemri dhe pastaj ose numri dokumentit të identifikimit ose data e lindjes duhet të jepet për verifikim, nëse një individ është në LPV dhe prandaj vota e tij ose e saj me kusht duhet të llogaritet. Megjithatë, gjatë verifikimit në QNR, numrat e dokumenteve serbe të identifikimit ishin futur në bazën e të dhënave të LPV-së, e cila me sa duket i njeh vetëm numrat e dokumenteve të identifikimit të Kosovës. Pas refuzimit të numrit të dokumentit të identifikimit, nuk është ndërmarr asnjë verifikim i mëtejshëm (duke përdorur emrin dhe mbiemrin dhe datën e lindjes). Ndonëse është e vërtetë se pothuajse të gjithë votuesit që janë në LPV posedojnë dokument identifikimi të Kosovës (për shkak se regjistri i dokumenteve të identifikimit të Kosovës është ai mbi të cilin bazohet LPV, edhe pse sipas drejtorit të regjistrimit civil, në LPV ende ka një numër të vogël votuesish të cilët posedojnë vetëm dokumente identifikimi të UNMIK-ut), fakti që ata u identifikuan me dokumente identifikimi serbe nuk do të thotë se ata nuk i posedonin edhe ato të Kosovës. Ishte konsideruar se ankuesi nuk kishte provuar pretendimet e tij me prova se ata votues kishin dokumente të vlefshme. Megjithatë, testi i vërtetë për votuesit me kusht do të duhej të ishte nëse ata janë në fakt në LPV, e jo nëse ata mund të

<sup>52</sup> Në disa raste, vendimet ju dërguan palëve pas afatit prej 72 orësh, megjithatë PZAP ka edhe pesë ditë të tjera shtesë pas marrjes së vendimit, ku preket certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve ka edhe 72 orë të tjera shtesë për tu dërguar kopje të vendimit të saj me shkrim palëve të përfshira.

gjenden në LPV duke përdorur një element të vetëm, d.m.th, numër identifikimi të Kosovës.<sup>53</sup> Ankuesi u ankua ndaj vendimit të PZAP-së në Gjykatën Supreme, e cila e refuzoi ankesën më 6 korrik.

Koalicionet mbahen përgjegjëse për gjobat e shkaktuara bashkërisht. Nëse një koalicion ndahet pas zgjedhjeve, të gjitha partitë të cilat e përbënin koalicionin do të duhet të sigurojnë pagesën e gjobave para se të mund të certifikohen për zgjedhjet e ardhshme komunale.

Niveli i ndërgjegjësimit për procedurat e PZAP-së në radhët e individëve (nëse nuk parashtrajnë ankesa përmes subjekteve politike apo OJQ-ve) është ende relativisht i ulët dhe nuk ishte pjesë e trajnimit të KVV-ve. Të paktën një vëzhgues vendorë që deshi të shkruajë një ankesë në librin e votimit në ditën e zgjedhjeve ishte kthyer mbrapsht në mënyrë jo të duhur nga kryetari i vendvotimit dhe më pas gabimisht i ishte thënë nga një anëtar i KKZ-së se ai nuk mund të paraqesë ankesë me PZAP pa nënshkrimin e kryesuesit.

### Ankesat në Gjykatën Supreme

Më 4 korrik, pesë prej vendimeve të PZAP-it janë ankimuar në Gjykatën Supreme. Gjykata Supreme i refuzoi tri si të pabazuara: dy nga kandidatët e koalicionit LAA dhe një nga Lista Serbe.

Gjykata dha miratimin në dy raste: Z. Jollxhi Shala (Kosovski Nevi Romani Partia - KNRP) pretendoi se kishte pasur parregullsi në disa komuna. Gjykata Supreme e ktheu çështjen për rishqyrtim nga PZAP, e cila pjesërisht e miratoi ankesën, duke urdhëruar KQZ-në që të bëj rinumërimin në 23 vendvotime. Rinumërimi u zhvillua më 6 korrik 2017 i cili nuk e ndryshoi ndarjen e mandateve. Gjykata Supreme e miratoi një ankesë tjetër nga Z. Vehbi Imeri, kandidat i LAA-së, dhe kërkoi nga PZAP që të rishqyrtojë çështjen. PZAP ka rishqyrtuar rastin duke rinumëruar pjesërisht vendvotimet. Nuk kishte asnjë ndryshim në rezultate. Ndërkaq, z.Vehbi Imeri nuk e apeloj vendimin e dytë të PZAP-së. Pas përfundimit të procesit të ankesave, KQZ certifikoi rezultatet përfundimtare më 8 korrik 2017, duke hapur rrugën për krijimin e institucioneve të reja.

## **B. Mbrojtja e votës**

Shkeljet që mund të ndikojnë rezultatet e zgjedhjeve, përveç se janë shkelje administrative, mund të jenë edhe vepra penale. Në raste të tilla, PZAP e dërgon çështjen në zyrën e Kryeprokurorit, për të ndjekur çështjen penale. Kjo nuk e zhvesh PZAP-në nga juridiksioni për të përcaktuar përgjegjësinë administrative. Bashkëpunimi i PZAP-it me policinë dhe prokurorinë është përmirësuar përmes institucionalizimit të Memorandumit të Mirëkuptimit e lidhur mes këtyre institucioneve dhe KQZ-së.

Plani operativ i policisë dhe Koordinatorit Kombëtar për Zgjedhjet në kuadër të Zyrës Kryeprokurorit që përfshinte shpërndarjen e deri në 100 prokurorëve në ditën e zgjedhjeve rezultoi në dymbëdhjetë raste ku ishin të përfshirë 13 individë dhe një numër të paraburgimeve të përkohshme. Shumica e rasteve ishin ende nën hetim policor në fillim të korrikut. Koordinatori Kombëtar për Zgjedhjet beson se rreth tetë raste me tetë individë mund të përfundojnë me aktakuza. Deri tani, prokuroria ka ngritur katër aktakuza. Gjykatat tashmë kanë gjykuar tri raste, një në Pejë për shkeljen e përcaktimit të lirë të votuesve (neni 213 i Kodit Penal). I akuzuari u kap duke i udhëzuar votuesit se për kë të votojnë. Ai është gjetur me 32 fletë votimi, nga të cilat 27 veç ishin plotësuar për të njëjtit kandidatë. Kryesi u gjobit me 700 euro. Për një rast tjetër të ngjashëm është ngritur aktakuzë në Pejë, ku i akuzuari ishte

<sup>53</sup> Shih fusnotën 52.



vëzhgues i një partie prandaj u dënua për keqpërdorim të detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve (neni 214 i Kodit Penal). MVZ nga BE nuk ka njohuri për asnjërin prej këtyre rasteve se nëse hetimet kishin të bënin edhe me zinxhirin e mundshëm komandues. Gjykata gjithashtu vendosi edhe për një aktakuzë tjetër në Prishtinë (lidhur me komunën e Graçanicës), për asgjësimin e dokumenteve të votimit (neni 220 i KP-së). I akuzuari, duke qenë nën ndikimin e alkoolit, ka grisur fletëvotimin e tij dhe ka fyer anëtarët e KVV që nuk e kishin lejuar të birin e tij të votojë. Personi e pranoi fajësinë pas 48 orësh arrestimi dhe u dënua me 10 muaj burgim me kusht - një dënim njaft i ashpër duke pasur parasysh se ai kishte grisur vetëm fletëvotimin e tij, por dënimi minimal në fakt është një vit burgim. Aktakuza tjetër, lidhur me krimin e pretenduar të kanosjes ndaj një kandidati (neni 211 i KP-së) në Pejë është ende në proces. I dyshuari e kishte kërcënuar një kandidatë të SLS-së në fshatin Brestovik që të tërhiqet nga lista, ose ndryshe do të përjashtohej nga puna. Raste të ngjashme janë raportuar në komunën e Graçanicës. MVZ u takua me katër kandidatët e SLS-së të cilët kishin humbur vendet e tyre të punës (në kompanitë e energjisë të drejtuara nga Beogradi), supozohet pasi u ishte thënë se duhet që të heqin dorë nga kandidatura e tyre dhe pasi kishin refuzuar që ta bëjnë këtë. Vetëm një nga këto raste, ku kandidati pohoi të ketë dëshmi mbështetëse përveç njoftimit për shkarkim, u dorëzuar në prokurori. Më 3 korrik, prokurori raportoi se kanë përfunduar hetimet sepse nuk ishte përcaktuar lidhja në mes të largimit nga puna dhe një krimi zgjedhor.<sup>54</sup>

Baza e të dhënave të QNR-së nuk lejon përcjelljen e ndryshimeve në proces (për shembull, se sa vota ishin këtu në pranimin e parë, kush çka ka ndryshuar...), ose të marrë një rast, të bëjë komente dhe ta përcjellë atë në KQZ për trajtim të mëtejshëm (si dërgimi në prokurori). Megjithatë, KQZ-ja pretendon se do të dërgojë në prokurori të gjitha votat e dyfishta<sup>55</sup> dhe të gjitha rastet e rinumërimit kur ka më shumë gjasa të ketë pasur mashtrim e jo thjeshtë gabim. PZAP po ashtu e ka deklaruar synimin e saj për të dërguar rastet e supozuara të krimeve zgjedhore në prokurori. Koordinatori Kombëtar për Zgjedhjet në Zyrën e Kryeprokurorit ka deklaruar se prokuroria do të përpiqet që të lëviz shpejt në këto raste pasi të pranohen ato, në mënyrë që të dërgojë sinjale të duhura të preventimit me kohë për zgjedhjet komunale, kurdo që është e mundur.

Në kontrast të plotë me veprimin agresiv të disa prej prokurorëve të caktuar dhe madje edhe disa gjyqtarëve të gjykatave themelore në dhe rreth ditës së zgjedhjeve, është dëshmuar pothuaj e pamundur që të përcillen deri mbi 600 pretendime për krime zgjedhore të cilat janë dërguar në prokurori pas zgjedhjet parlamentare të vitit 2014. Ndërsa jo çdo pretendim do dhe duhet të çojë në aktakuzë, këto janë përcjellë nga institucionet kompetente, pas një vlerësimi të parë ligjor.<sup>56</sup>

<sup>54</sup> Sipas prokurorit, kandidati ishte njoftuar nga punëdhënësi i tij, një kompani e energjisë elektrike me bazë në Beograd e cila ende i mban serbët e Kosovës në listën e pagave, se është konstatuar se kandidati ishte i punësuar edhe në Shërbimin Postar të Kosovës. Ai pastaj u pezullua përkohësisht, iu tërhoq vërejtja se do të largohej nga puna nëse nuk hiqte dorë nga njëra prej dy pozitave, apo edhe eventualisht do të largohet. Rasti, bashkë me rastet e tjera të kandidatëve të larguar nga vendet e punës në kompaninë serbe të energjisë elektrike duket se është në Gjykatën e Punës në Beograd. Duhet të thuhet se derisa ka mundësi që të ketë pasur bazë ligjore për largim nga puna (që nuk kishin punuar në fakt për njerëzit e mbajtur në listën e pagave mund të jetë njëra), po ashtu është e mundur që këta katër kandidatë ishin pikasur për largim nga puna pikërisht për shkak të kandidaturës së tyre.

<sup>55</sup> Prokuroria duhet të ketë kujdes të madh që të shikoj dokumentet dhe nënshkrimet origjinale kur e ndjek penalisht dikë për shkak se ka votuar më shumë se një herë, sepse janë gjetur raste në QNR ku ishte futur një numër i gabuar i dokumentit identifikues, duke krijuar kështu një regjistrim të rrejshëm të dyfishtë, dhe janë të mundshme edhe forma të tjera të abuzimit ose gabimit.

<sup>56</sup> Nga zgjedhjet e vitit 2014, 169 akuza penale u ngritën nga policia, inspektorati dhe subjektet e ngjashme, më shumë se 400 nga KQZ (sipas Udhëheqësit të Shërbimeve Ligjore në KQZ, një raport i D4D – “Vendosja e Drejtësisë në Zgjedhje” flet për 239 raste që janë referuar në prokurori nga KQZ) dhe 34 nga PZAP.

Për shkak të mungesës së një sistemi të integruar (ose çfarëdo) të menaxhimit të rasteve në mes të prokurorisë së Kosovës dhe sistemit gjyqësor, është e vështirë mbledhja e të dhënave për rastet e ndjekura penalisht. Këto të dhëna prodhohen në mënyrë manuale varësisht nga nevojat e institucionit përkatës. Të dhënat për ndjekjen penale pas zgjedhjeve të 2014 janë mbledhur nga shtatë prokuroritë kryesore në Kosovë. Të dhënat e ofruara tregojnë se prokuroritë në Kosovë kanë trajtuar 23 aktakuza për vepra penale që përfshinin 26 të dyshuar lidhur me zgjedhjet 2014. Të gjitha këto raste çuan në dënime me kusht, përveç një rasti në Mitrovicë, i cili është ende nën hetim.

Përveç faktit se informacioni i dhënë në 23 rastet e mësipërme ishte shumë i pakët, mbetet pyetja se çfarë ndodhi me të gjitha akuzat e tjera. Edhe pse MVZ nga BE ju tha se ato mund të jenë ende nën hetime, nuk ka informacione zyrtare për të konfirmuar këtë. Kjo mungesë e provave se të gjitha ose shumica e krimeve elektorale janë ndëshkuar ka mundësi të zvogëlojë efektin përmbajtës të legjislacionit për krime zgjedhore.

## **XII. VËZHguesIT E ZGJEDHJEVE**

Roli, të drejtat dhe detyrimet e vëzhguesve të akredituar janë përcaktuar në LZP (nenet 54-58) dhe në rregulloren e KQZ-së 07/2013. Ligji parashikon që "Subjektet politike të certifikuar, OJQ-të dhe organizatat qeveritare e ndër-qeveritare, sikurse edhe organizatat ndërkombëtare të specializuara të cilat merren me zgjedhjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, dhe përfaqësuesit e vendeve të huaja, kanë të drejtë të kërkojnë akreditim të vëzhguesve për zgjedhje". KQZ-ja është përgjegjëse për lëshimin e akreditimit me kërkesën e vëzhguesit apo subjektit që ai/ ajo e përfaqëson.

Për zgjedhjet parlamentare të 2017, KQZ ka akredituar gjithsej 29,264 vëzhgues nga partitë politike, koalicionet, organizatat ndërkombëtare, OJQ-të vendore, ambasadat dhe mediat. Koalicionet kanë akredituar numrin më të madh të vëzhguesve: 15,784 vëzhgues nga pesë koalicione, LAA kishte 8,306 dhe PAN kishte 6,766 vëzhgues.<sup>57</sup> OJQ-të lokale akredituan gjithsej 8,830 dhe organizatat ndërkombëtare 301 vëzhgues.

Demokracia në Veprim, një koalicion i OJQ-ve, ishte grupi kryesor i vëzhguesve vendorë të zgjedhjeve. Ajo i shpërndau në terren mbi 2,500 vëzhgues dhe publikoi disa raporte për fushatën zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve.

Një numër çuditërisht i madh i vëzhguesve (4,548) u akredituan nga KQZ-ja nga një OJQ e quajtur Instituti Rajonal i Demokracisë, të Drejtave të Njeriut dhe Studimeve Politike. Shumica e këtyre vëzhguesve ishin akredituar pak para afatit të fundit dhe OJQ-ja u akuzua nga bashkëbiseduesit e MVZ nga BE se ishte mbulesë për partitë politike që të kenë vëzhgues shtesë të akredituar brenda vendvotimeve. Kjo OJQ pak e njohur nuk kishte as faqe interneti, nuk kishte vëzhguar kurrë zgjedhje më përpara dhe nuk kishte raportuar publikisht për zgjedhjet.<sup>58</sup>

---

<sup>57</sup> Subjekteve të certifikuar politike, përfshirë koalicionet, u lejoheshin vetëm nga dy vëzhgues që të jenë të pranishëm në vendvotime në të njëjtën kohë. Megjithatë, vëzhguesit e BE-së vërejtën një prani të më shumë se dy vëzhguesve nga koalicionet PAN ose LAA në një varg vendvotimesh të vizituara.

<sup>58</sup> Kur u pyetën nga vëzhguesit e BE-së, disa prej këtyre "vëzhguesve të OJQ-ve" nuk e dinin madje as emrin e OJQ-së që e përfaqësonin.

## REKOMANDIMET

### Korniza ligjore

Nr.	Faqe	Qëllimi	Rekomandimi	Aktivitetet e sugjeruara	Institucionet e synuara	Parimi
1	f.12	Që në rastin e zgjedhjeve të parakohshme të gjitha afatet ligjore të përcaktuara në kuadër të procesit zgjedhor të respektohen në mënyrë të rreptë dhe të mos mbivendosen, në mënyrë që të garantojë gëzimin e plotë të të gjitha të drejtave lidhur me zgjedhjet nga të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor.	<p>Zgjedhjet e parakohshme në mënyrë ideale duhet të thirren me të njëjtin njoftim sikur zgjedhjet e rregullta.</p> <p>Minimumi absolut për zgjedhje që garantojnë të gjitha të drejtat lidhur me zgjedhjet do të jetë njoftimi prej dy muajsh.</p> <p>Para çdo ndryshimi të kornizës ligjore, thirrja për zgjedhje të parakohshme në më pak se 45 ditë pas shpërndarjes së Kuvendit duhet të shmanget.</p>	<p>Ndryshimi i Kushtetutës (neni 66.2)</p> <p>Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme neni 4, dhe</p> <p>Rregullores së KQZ-së Nr. 15/2013</p>	Kuvendi i Kosovës dhe KQZ-së.	<p>Siguria ligjore / stabiliteti i rregullave CGPEM (Komisioni i Venecias)</p> <p>Kapitulli 2</p> <p>E drejta për mjet juridik efektiv: Neni 13 i KEDNJ-së; ICCPR Neni 2</p> <p>Zgjedhjet e mirëfillta ICCPR Neni 25</p>
2	f.10	Të ofrohet siguri ligjore për përmbajtjen zgjedhore, si dhe për afatet për ankesa të ndryshme.	Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) duhet të ndryshohet për të inkorporuar rregullat themelore zgjedhore aktualisht të përcaktuara në rregulloret e KQZ-së, p.sh. për funksionimin e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve, rregullat për rinumërim dhe	<p>Ndryshimi dhe konsolidimi i LZP-së së ndryshuar.</p> <p>Një ndryshim që prek pjesë të konsiderueshme të tekstit po ashtu do të çojë në botimin</p>	Kuvendi i Kosovës në bashkëpunim të ngushtë me KQZ, PZAP	Siguria juridike, CGPEM (VC) Kapitulli 2: KEDNJ, Neni 13; ICCPR, Neni 2.

			anulime. Kapitulli për ankesat do të përfitonte nga një qartësi më e madhe në lidhje me afatet dhe përmbajtjen e nevojshme të ankesave.	shumë të nevojshëm të një versioni të konsoliduar të LZP dhe Ligjit (s) Amendamentit.		
--	--	--	--	---	--	--

### Mbrojtja e të drejtave zgjedhore

3	f.29	T'i jepet kohë e mjaftueshme ankuesit për të përgatitur ankesën lidhur me votimin dhe numërimin dhe të paraqesin prova dhe PZAP-së për të shqyrtuar provat para marrjes së vendimit.	Afati për paraqitjen e një ankese për zgjedhje duhet të zgjatet në 48 orë, dhe afati kohor për PZAP për të vendosur për të në 4 ditë/ 96 orë.	Ndryshimi i LZP.	Kuvendi i Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me KQZ-në dhe PZAP-it.	E drejta për mjet efektiv; KEDNJ, Neni 13; ICCPR, Neni 2; UDHR, Neni 8.
4	f.30 deri 31	Rritja e transparencës së procesit të parashtrësive dhe ankesave.	PZAP dhe Gjykata Supreme duhet të publikojnë parashtrësat dhe ankesat dhe vendimet në faqet e tyre të internetit në kohën e duhur.	Ndryshimi i Ligjit për Gjykatat.	Kuvendi i Kosovës, PZAP dhe Gjykata Supreme.	Transparenca
5	f.29 deri31	Të sjell procedurat ankimore lidhur me shkeljet zgjedhore më afër votuesve.	Duhet të hapen degë të PZAP-së në shtatë rajone gjatë zgjedhjeve.	Ndryshimi i LZP.	Kuvendi i Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me PZAP	Të drejtat për mjete efektive, KEDNJ, neni 13; ICCPR, Neni 2; UDHR, Neni 8.
6	f.31	Përmirësimi i njohurive	Procedurat e ankesave duhet të	Ndryshimi i	KQZ, PZAP	E drejta për mjet

	deri 32	të KVV dhe votuesve rreth procesit të ankesave	përfshihen në manualin e trajnimit të KVV-ve dhe në informatat e përgjithshme për votuesit.	manualit të trajnimit të KVV-ve, ofrimi i edukimit adekuat të votuesve.		efektiv; KEDNJ, Neni 13; ICCPR, Neni 2
7	f.31 deri 32	Sigurimi i të drejtës së qytetarëve për të shprehur preferencat e tyre politike, si votues dhe si kandidatë.	Prokurorë special për zgjedhjet duhet të caktohen për secilën komunë që në fillim të periudhës së fushatës.  Institucionet duhet të sigurojnë hetimin e shpejtë dhe të duhur, ndjekjen dhe gjykimin e rasteve të kërcënimit të votuesve dhe kandidatëve.	Kryerja e hetimeve të plota mbi pretendimet e frikësimit/ presionit p.sh. duke caktuar prokurorë special për secilën komunë që në fillim të periudhës së fushatës.	Policia Prokuroria Gjykatat Këshilli Gjyqësor i Kosovës	E drejta e votës të lirë; Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës
8	f.32	Rritja e besueshmërisë së procesit zgjedhor, dekurajomi i krimeve zgjedhore.	Duhet të krijohet një bazë të dhënash me një numër të vetëm, ku rastet lidhur me zgjedhjet mund të gjurmohen nga policia në prokurori deri te vendimi i gjykatës. Nëse kjo bazë e planifikuar e të dhënave nuk bëhet funksionale deri në janar 2018, duhet të zbatohet një sistem i veçantë.	Krijimi i një bazë të dhënash me një numër të vetëm, ku rastet mund të përcillen nga policia në prokurori deri te vendimi i gjykatës.	Policia Prokuroria Gjykatat Këshilli Gjyqësor i Kosovës	E drejta e votës së lirë, e drejta për mjet juridik efektiv; KEDNJ, Neni 13; ICCPR, Neni 2; UDHR, Neni 8.  Shprehja e lirë e zgjedhjes votuesve, zgjedhje të mirëfillta; ICCPR Neni 25
9	f.32	Rritja e besueshmërisë së procesit zgjedhor, dekurajomi i krimeve zgjedhore.	Të gjitha krimet zgjedhore, përfshirë edhe ato të kryera gjatë zgjedhjeve të mëparshme, duhet të hetohen në mënyrë energjike, të ndiqen penalisht, dhe aty ku përcaktohet përgjegjësia personale,	Kryerja e hetimeve të plota, ndjekjen penale dhe gjykimin në lidhje me akuzat për krime elektorale.	Policia Prokuroria Gjykatat Këshilli	E drejta e votës të lirë; Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore e Komisionit të Venecias

			të ndëshkohen. Zinxhirët e komandës duhet të hetohen dhe të ndiqen penalisht nxitësit.  Institucionet duhet të sigurojnë hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e shpejtë dhe të duhur të rasteve të mashtrimit zgjedhor.	Siguron botimin e rregullt dhe të gjerë të rezultateve të këtyre përpjekjeve.	Gjyqësor i Kosovës	të Këshillit të Evropës
--	--	--	--	---	--------------------	-------------------------

#### Administrimi i zgjedhjeve

Nr.		Qëllimi	Rekomandimi	Aktivitetet sugjeruara	Institucionet e synuara	Parimi
10	f.14 deri 16	Përmirësimi i kapacitetit të administratës zgjedhore për të zhvilluar zgjedhje në përputhje me standardet në rast të zgjedhjeve të parakohshme	Në rast të zgjedhjeve të parakohshme, <i>ndër të tjera</i> , duhet të zgjatet afati për të paraqitur listën e votuesve dhe periudha e kontestimit, për aplikacionet për votim të personave me nevoja të veçanta, për regjistrim dhe votim jashtë Kosovës, dhe për caktimin e vendvotimit.	Ndryshimi i Kushtetutës, LZP, Rregullores së KQZ-së Nr. 15/2013.	Kuvendi i Kosovës, dhe KQZ-ja.	Zgjedhjet e mirëfillta. E drejta për të votuar  ICCPR, Komenti i Përgjithshëm 25, paragrafi 11

11	f.15 f.27	Përmirësimi i kapaciteteve të votuesve që vota e tyre të jetë e vlefshme	Informacioni për votuesit duhet përmirësohet në mënyrë substanciale; në veçanti, lidhur me atë se si të plotësohet një fletëvotim, si të regjistrohen dhe të votojnë jashtë Kosovës, si të ndryshohet vendi i votimit, dokumentet identifikuese të pranueshme.	Informimi i votuesve duke përdorur metoda dhe kanale të ndryshme (media sociale online, OJQ-të) në tërë Kosovën, dhe vënia në shënjestër e votuesve për herë të parë, diasporës, zonat rurale, komunitetet, personat me aftësi të kufizuara	KQZ	E drejt për të votuar, ICCPR neni 25  Transparenca dhe e drejta në informim  ICCPR, Komenti i Përgjithshëm 25, paragrafi 11, 12; Komenti i Përgjithshëm 34
12	f.27 deri 28	Të përmirësohet efikasiteti dhe performanca e administratës së zgjedhjeve	Trajnimi i zyrtarëve të zgjedhjeve në nivel të vendvotimit dhe atë komunal duhet të intensifikohet duke marrë parasysh mangësitë e vërejtura (numërimi i votave, rregullat e vlefshmërisë së fletëvotimit, plotësimi i formularëve të rezultateve, paketimi i materialit zgjedhor, dokumentet e identifikimit).	Përmirësimi i materialit të trajnimit dhe kurrikulës për komisionarët e zgjedhjeve (ushtrime praktike interaktive, video)	KQZ	Zgjedhje të mirëfillta  ICCPR Komenti i Përgjithshëm nr. 25, paragrafi 20
13	f.16	Adresimi i mangësive në procedurat e votimit jashtë Kosovës	Duhet të mendohen afate kohore më të gjata dhe masa shtesë mbrojtëse në mënyrë që të përmirësohet përfshirja dhe integriteti i procesit të votimit jashtë Kosovës.	Ndryshimet e LZP, Rregullores së KQZ-së 03/2013	Kuvendi i Kosovës, KQZ	E drejta dhe mundësia për të votuar
14	f.15	Të përmirësohet saktësia e listave të votuesve dhe caktimi i votuesve në	Duhet bërë përpjekje substanciale për të hequr personat e vdekur nga regjistrat civilë, dhe për të krijuar	Agjencia e Regjistrimit Civil dhe institucionet përkatëse të zbatojnë	Agjencia e regjistrimit Civil,	E drejta universale dhe e barabartë e votës, Kodi i Praktikave të

		vendvotime	një sistem të unifikuar të adresave në Kosovë.	një sistem të unifikuar të adresave, dhe KQZ të caktojë si duhet votuesit nëpër vendvotime	Ministria e Brendshme, Agjencia Kadastrale e Kosovës, Komunitat, KQZ	Mira në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës 1.2.ii
15	f.14	Përmirësimi i pjesëmarrjes së grave në administratën e zgjedhjeve	Zbatimi i deklaratës së partive politike të vitit 2015 për të siguruar të paktën 40% të pjesëmarrjes së të dy gjinive në procesin zgjedhor.	Ndryshimi i Rregullores së KQZ-së 18/2016 dhe 19/2016	KQZ, subjektet politike	Barazia gjinore CEDAW, neni 3
16	f.27 deri 28	Përmirësimi i transparencës, konsekuencës, saktësisë dhe besimit të publikut në procesin e Tabelimit të Rezultateve	Procesi i tabelimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve duhet të përmirësohet në mënyrë substanciale duke siguruar më shumë resurse, trajnim të stafit dhe përmirësim të teknologjive. FRK-të dhe FPR-të duhet të qartësohen	Ri-dizajnimi i KQZ-së për të përdorur teknologjitë moderne për përmirësimin e saktësisë dhe informimit për të gjitha aspektet e tabelimit, numërimit dhe rinumërimit.	KQZ, QNR, IFES, Donatorët ndërkombëtarë	Zgjedhje të mirëfillta, Transparenca dhe drejta në informim
17	f.28	Përmirësimi i transparencës dhe besimit të publikut në trajtimin e votave me kusht në QNR	Procedurat për trajtimin e votave me kusht duhet të qartësohet, veçanërisht sa i përket verifikimit të identitetit dhe të drejtës; vëzhguesit duhet të jenë në gjendje të vëzhgojnë procesin e verifikimit.	Qartësimi i procedurave të votimit me kusht, ofrimi i mundësive për vëzhgimin e trajtimin të votave me kusht	QNR, KQZ	E drejta për votim, Zgjedhjet e mirëfillta, ICCPR Komenti i Përgjithshëm Nr. 25, paragrafi 20
18	f.25	Përmirësimi i integritetit dhe garantimi i	Trajnimi i zyrtarëve zgjedhorë duhet të përfshijë një fokus për	Trajnimi i përmirësuar i	KQZ	Zgjedhjet e mirëfillta,



		fshehtësisë së votës	parandalimin e votimit familjar/ grupor dhe abuzimin me ndihmën në votim	KVV-ve		ICCPR Komenti i Përgjithshëm Nr. 25, paragrafi 20
--	--	----------------------	--	--------	--	---

### Fushata

Nr.		Qëllimi	Rekomandimi	Aktivitetet e sugjeruara	Institucionet e synuara	Parimi/Standardi
19	f.10	Sigurimi i konsistencës ligjore për rregullat e fushatës zgjedhore	Rregullat e fushatës lidhur me njoftimin dhe organizimin e ngjarjeve politike, rregullat për postime zgjedhore dhe rregullat për përfshirjen e nëpunësve civilë në fushatat zgjedhore duhet të zhvillohen më tej në LZP.	Ndryshimi i LZP për të përfshirë dispozitat që aktualisht gjenden në rregulloren zgjedhore nr. 13/2013 për fushatat zgjedhore.	Kuvendi i Kosovës, KQZ	Qartësia ligjore
20	f.20	Përmirësimi i pjesëmarrjes së grave në procesin zgjedhor	Partitë politike duhet të identifikojnë masa efektive për rritjen e pjesëmarrjes së grave në pozita udhëheqëse në aktivitete të partisë/aktivitete zgjedhore.	Ndryshimet e rregullave të brendshme të procedurave të partive politike	Subjektet politike Shoqëria civile	CEDAW, Neni 3 & neni 7; Udhëzimet për rregullimin e partive politike nga OSBE/ODIHR dhe Komisioni të Venecias, Kapitulli IX. 100, 101

### Financimi i fushatës

Nr.		Qëllimi	Rekomandimi	Aktivitetet e sugjeruara	institucionet në	Parimi / Standard
-----	--	---------	-------------	--------------------------	---------------------	-------------------

					shënjestër	
21	f.20	Zbatimi efektiv i kushteve për financimin e fushatës	Auditimi i financave të fushatës së pjesëmarrësve në zgjedhje duhet të kryhet në mënyrë efektive.	<p>Kuvendi i Kosovës duhet të bëj auditimin e financave të partive politike në përputhje me ligjin aktual dhe duhet të ndajë çdo vit fonde të mjaftueshme për auditim.</p> <p>Rritja e burimeve të Zyrës së KQZ-së për Regjistrimin dhe Certifikim e Partive Politike për të siguruar trajnimin e duhur të zyrtarëve financiarë të partive politike.</p>	<p>Kuvendi i Kosovës</p> <p>KQZ</p>	<p>Zbatimi i rregullave të fushatës;</p> <p>Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës, Kapitulli II.3.5 mbi Financimin në Raportin Shpjegues</p>
22	f.20	Të rritet transparenca në financimin e fushatës	Pjesëmarrësit në zgjedhje duhet të mbajnë një llogari të veçantë bankare për financimin e fushatës, ku u mbledhin të gjitha burimet e të ardhurave dhe shpenzimet gjatë fushatës, si në nivel qendror ashtu edhe rajonal.	<p>Ndryshimet në Ligjin nr. 03 / L-174 për financimin e partive politike</p> <p>Konsultimet publike me palët e interesuara për të identifikuar institucionin e duhur për të kryer një auditim të pavarur të raporteve financiare.</p>	<p>Kuvendi i Kosovës</p> <p>KQZ</p>	<p>Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës, Kapitulli II.3.5 mbi Financimin në Raportin Shpjegues</p>

23	f.20	Të rritet transparencën në financimin e fushatës	Pjesëmarrësit në zgjedhje duhet të paraqesin raporte financiare jo më vonë se 30 ditë pas ditës së zgjedhjeve.	Ndryshimet në LZP.	Kuvendi i Kosovës KQZ	Rregullsinë e procesit zgjedhor / Udhëzimet për rregullimin e partive politike, nga OSB / ODIHR dhe Komisioni i Venecias (2010)
----	------	--	--	--------------------	--------------------------	---

## Media

Jo.		qëllim	rekomandim	Aktivitetet e sugjeruara	Institucionet e synuara	Parimi / Standardi
24	f.22	Të sigurohen sanksione efektive të shkeljeve dhe korrigjimet pas ankesave gjatë periudhës së zgjedhjeve.	Bordi i KPM-së duhet të ketë parasysh që të mbajë takime të rregullta dhe të shpeshta për shqyrtimin e ankesave të pranuar dhe shkeljet e gjetura nga monitorimi i mediave nga KPM dhe të marr vendime me kohë.	Të mbahen takime javore të anëtarëve të Bordit të KPM-së gjatë periudhës së zgjedhjeve, për të diskutuar raportet javore të monitorimit të mediave dhe ankesat e pranuar.	Komisioni i Pavarur për Media	Neni 15.3, Ligji për Komisionin e Pavarur për Media.
25	f.22	Të përmirësohet transparencën dhe besimi i publikut.	Duhet marrë në konsideratë që të ndahen me publikun informacionet mbi rastet e hapura për ankesat dhe shkeljet. Të publikohen me kohë vendimet e marra nga KPM-ja.	Të mbahet një bazë e të dhënave publike të rasteve të hapura apo të ndajhet ky informacion sipas kërkesës, dhe të publikohet në faqet e internetit vendimet e marra nga KPM-ja.	Komisioni i Pavarur për Media	Neni 15.7, Ligji për Komisionin e Pavarur për Media.
26	f.24	Të sigurohen kushte të	Duhet marrë në konsideratë	Ndryshimi i nenit 49 të Ligjit	Kuvendi i	Neni 2, Ligji mbi

		barabarta për garuesit për të blerë kohën e transmetimit me pagesë dhe harmonizimi i kufizimeve për transmetuesit për transmetimin e materialeve me pagesë.	rregullimin e programeve të sponsorizuara nga partitë politike ngjashëm me spotet reklamuese politike me pagesë.	për Zgjedhjet e Përgjithshme, ndryshimi i Rregullores KPM-2016/02 të Komisionit të Pavarur për Media.	Kosovës, Komisioni i Pavarur për Media	Zgjedhjet e Përgjithshme; Neni 2.3, Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës.
--	--	---	--	---	---	---

## SHTOJCA 1: REZULTATET E CERTIFIKUARA TË ZGJEDHJEVE

Votues të regjistruar	1,888,059
Numri i zgjedhësve që kanë votuar në vendvotime	747,228
Votat me kusht, votimi i personave me nevoja të veçanta, votimi jashtë Kosovës	32,501
Pjesëmarrja (%)	41,30
Fletëvotime të vlefshme	727,986
Fletëvotime të pavlefshme	42,554
Fletëvotime të zbrazëta	6553
Fletëvotime të përdorura	777,191
Fletëvotime të papërdorura	924,087
Fletëvotime të dëmtuara	1746

Subjekti politik	Votat	% e votave	Ulëset	% e ulëseve
12 (PAN) Partia Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Nisma për Kosovën, Partia e Drejtësisë Lëvizja për Bashkim, Partia Shqiptare Demokratike e Kosovës, Partia Konservatore e Kosovës, Alternativa Demokratike e Kosovës, Republikanët e Kosovës, Partia e Ballit, Partia Socialdemokrate, Balli Kombëtar i Kosovës.	245.627	33,74	39	32,50
35 Lëvizja VETËVENDOSJE!	200.135	27,49	32	26,67
16 (LAA) LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS ALEANCA KOSOVA E RE	185.884	25,53	29	24,17
22 GRAÐANSKA INICIJATIVA SRPSKA LISTA	44.499	6,11	9	7,50
29 FJALA	7.992	1,10	-	-
26 KOSOVA DEMOKRATIK TÛRK PARTISI	7.852	1,08	2	1,67
30 KOALICIJA VAKAT	6.443	0,89	2	1,67
32 NOVA DEMOKRATSKA STRANKA	3.652	0,50	1	0,83
21 SAMOSTALNA LIBERALNA STRANKA	3.540	0,49	1	0,83
19 PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS	2.425	0,33	1	0,83
24 PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE	2.415	0,33	1	0,83
11 JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA	2.369	0,33	1	0,83
27 PARTIJA KOSOVSkih SRBA-AKTIVNA GRAÐANSKA INICIJATIVA	2.126	0,29	-	-
13 PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM	2.107	0,29	1	0,83
18 PROGRESIVNA DEMOKRATSKA STRANKA	1.698	0,23	-	-
20 INICIJATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS	1.521	0,21	-	-
34 KOALICIJA SDA	1.355	0,19	-	-
33 KOSOVA TÛRK ADALET PARTISI	1.347	0,19	-	-
17 POKRET ZA GORA	1.020	0,14	-	-
36 PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS	955	0,13	1	0,83
25 KOSOVAKI NEVI ROMANI PARTIA	951	0,13	-	-

15 GRADANSKA INICIJATIVA GORE	813	0,11	-	-
28 PARTIA DEMOKRATIKE E UNITETIT	478	0,07	-	-
31 GI. ZA PROSPERITET KOSOVA	311	0,04	-	-
14 G I EROMENDJE ALTERNATIVA	244	0,03	-	-
23 NAPREDNA SNAGA KOSOVA	227	0,03	-	-
GJITHSEJTË	727.986	100,00	120	100,00

## SHTOJCA 2: MONITORIMI I MEDIAVE

### REZULTATET E MONITORIMIT TË MEDIAVE NGA MVZ i BE-së Zgjedhjet e parakohshme parlamentare, Kosovë 2017

#### HYRJE

MVZ i BE-së, nga 22 deri më 30 maj 2017, gjatë periudhës së fushatës parazgjedhore, ka bërë një monitorim cilësor të mediave për katër kanalet televizive (RTK1, RTV21, KTV dhe Klan Kosova TV) nga ora 18:00 deri 00:00 çdo ditë.



Gjatë fushatës zgjedhore, 31 maj - 9 qershor 2017, ekipi për mediat i MVZ nga BE ka bërë monitorimin sasior dhe cilësor të mediave me një mostër të përbërë nga shtatë kanale televizive:

- ✓ **RTK1**, kanal televiziv publik (në gjuhën shqipe)
- ✓ **RTK2**, kanal televiziv publik (në gjuhën serbe dhe të komuniteteve jo-shumicë)
- ✓ **TV21**, kanal televiziv privat (në gjuhën shqipe)
- ✓ **KTV**, kanal televiziv privat (në gjuhën shqipe)
- ✓ **KLAN KOSOVA**, kanal televiziv privat (në gjuhën shqipe)
- ✓ **TV MOST**, kanal televiziv privat lokal (në gjuhën serbe)
- ✓ **PULS TV**, kanal televiziv privat lokal (në gjuhën serbe)

RTK1, RTK2, TV21, KTV dhe Klan Kosova janë monitoruar çdo ditë nga ora 17:00 deri në orën 01:00. TV MOST dhe TV PULS janë monitoruar çdo ditë gjatë transmetimit të lajmeve kryesore.



Gjithashtu MVZ nga BE-së ka kryer gjatë fushatës zgjedhore një monitorim cilësor të një mostre të lajmeve të mediave online dhe mediave sociale (faqe të Facebook).

## MBULIMI POLITIK DHE ELEKTORAL GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE







**RTK1 – KANALI TELEVIZIV PUBLIK (në gjuhën shqipe)**



<sup>59</sup> Shuma e përgjithshme e reklamave politike me pagesë: 11.130 sekonda.

Shuma e përgjithshme e programeve të sponsorizuara të fushatës: 32.146 sekonda.

### TV21 (KANAL TELEVIZIV PRIVAT)





60

<sup>60</sup> Shuma e përgjithshme e reklamave politike me pagesë: 11.130 sekonda.

Shuma e përgjithshme e programeve të sponsorizuara të fushatës: 32.146 sekonda.

**KTV (KANAL TELEVIZIV PRIVAT)**





61

<sup>61</sup> Shuma e përgjithshme e reklamave politike me pagesë: 11.130 sekonda.

Shuma e përgjithshme e programeve të sponsorizuara të fushatës: 32.146 sekonda.

### KLAN KOSOVA TV (KANAL TELEVIZIV PRIVAT)




62



<sup>62</sup> Shuma e përgjithshme e reklamave politike me pagesë: 10.105 sekonda.

Shuma e përgjithshme e programeve të sponsorizuara të fushatës: 58.479 sekonda.

**RTK2 – KANAL TELEVIZIV PUBLIK (në gjuhën serbe dhe të komuniteteve jo-shumicë)**



**TV MOST dhe TV PULS (KANALE PRIVATE TELEVIZIVE NË GJUHËN SERBE)**



## MBULIMI I KANDIDATËVE SIPAS GJINISË

